

## INTERVISTË ME AZEM VLLASIN

Rubofc | Data: 23 korrik, 2021

Kohëzgjatja: 150 minuta

Të pranishëm:

1. Azem Vllasi (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Besarta Breznica (Kamerë)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Anita Susuri:** Zoti Azem, nëse mundeni me dhonë një prezantim për vetën, me na tregu diçka për familjen e juaj, prejardhjen, fëmijërinë?

**Azem Vllasi:** Familja jonë këtu ku jemi sot në fshatin Rubofc afër Kamenicës, kanë ardhë në 1878 gjatë atij ekzodit t'madh të shqiptarëve në atë kohë. Serbia posa e ka fitue pavarësinë shtetënore në Kongresin e Berlinit, i kanë ndjek prej rrethit të Prokoplës, prej Nishit e te knej. Të mitë kanë ardhë prej rrethit të Leskocit, prej fshatit, fshatit Vllas. Si shumë shqiptarë që e bojnë mbiemrin simas vendit të origjinës, na e bojmë mbiemrin Vllasi, mas fshatit prej kah kanë ardhë t'mitë. Përndryshe, na jemi të fisit Krasniqi dhe po ta mbanim emrin si simas fisit, unë do të quhesha Azem Krasniqi.

*[Këtu ndërprehet intervista]*

Dhe këtu kemi metë, ka pasë dy tentime apo rreziqe të largohemi edhe nga këtu dhe nga Kosova. Tmerri i madh ka qenë në vitin 1912-13 gjatë Luftave Ballkanike. Gjatë një gjenocidi mund të quhet me përmasat që i ka pasë ndaj shqiptarëve, kur prej familjes tonë jonë vra atëherë njo pesë anëtarë. Pastaj në vitin 1955-56 kur ishte, quhej akcioni i mbledhjes të armëve kishe pa leje, por si shkas për t'i tmerru shqiptarët. E përmenihërë u përhap mundësia për shpërngulje në Turqi, dhe atëherë ka qenë një shpërngulje kogja e madhe e shqiptarëve në Turqi.

Këtu {përshkruan me dorë} kojshitë tanë, nja dy kojshi... nuk jemi fshat i madh, jemi tri, katër mahalla. Dy shkunë për Turqi. Baba jem edhe një prej asaj familjes i bonën paret m'i ble tokat e tyre. Baba jem ka qenë jo vetëm kundërshtarë, por agjitorë kundër shpërnguljeve në Turqi dhe edhe atëherë mbetëm këtu dhe këtu jemi sot e kësaj dite, djemtë e axhës të mi, vllazërit e mi, familja Vllasi.

**Anita Susuri:** Çka ju kujtohet prej fëmijërisë këtu në fshat?

**Azem Vllasi:** *Ahh* {onomatope}, fëmijëria gati për gjithkon është gati ajo pjesa ma e këndshme e jetës se t'kujtohen vetëm gjërat e mira. Na si familje kemi qenë e pasur, domethonë nuk dijmë për skamje. Tanët janë marrë krejt me punë bujqësore, blegtori, tokën e mirë e kemi. Vazhdimisht i kemi përcjellë të mëdhejt në ato punë dhe kur erdh koha m'u nisë në shkollë këtu në Kamenicë... Kamenica ka qenë e banume krejt me serbë, një qytezë e vogël afër këtu.

Na prej tri mahallave të Gajtanëve këtu, fqinjëve tanë Llazanëve dhe na ishmi njo, përmënjëherë një gjeneratë njo katër-pesë fëmijë m'u nisë në shkollë. U nisëm në shkollë, por si me thonë si që s'kishim kontakt përpara, s'ishmi msu kojshillak të përzimë. Me moshatarët tanë serbë në Kamenicë pakëz kishim do fërkime fminore anej-knej, por masi kalonte koha në përgjithësi kom pasë një fëmijëni të mirë, sepse e kishim fëmijëninë e përbashkët me kojshi, me mahallë, mirë deri në vitin 1964.

Kur e kreu shkollën fillore flitej se në Kamenicë do të hapej gjimnazi, por nuk ishte e sigurtë. Për mos t'humb kohë u regjistrova në Shkollën e Medicinës në, në Prishtinë. Babai jem fliste atëherë dhe i preferonte dy profesione. Njo mjek, "Doktor", thojke m'u bo, e dyta m'u bo gjyqtar apo avokat, domethonë jurist. U nisa në Shkollë të Medicinës, por pikërisht në atë vit u hap gjimnazi në Kamenicë dhe kushtet ma të mira këtu në shpi, dhe u ktheva prej Prishtine në gjimnaz. Gjimnazin e kom kry në vitin 1968.

Tash ishte puna kah të orientohna për studime. Në Prishtinë ishte Fakulteti Juridik-Ekonomik, Fakulteti Filozofik edhe m'doket i Shkencave Natyrore. Ishin Fakultete të Universitetit të Beogradit. Unë shkova në Beograd e regjistrova Fakultetin e Shkencave Politike, Degën e Gazetarisë, e kisha merak gazetarinë. Unë gazetat kom fillu t'i shpalosi si dikun në '63-tën a '64-tën a, hala as ka fundi... Mirëpo e pashë një ambient atje ndryshe.

Nji mik i imi i Gilanit, ma i vjetër se unë ja pashë hajrin, tha, "Nuk o gjo ajo, Shkencat Politike osht' profesion për masdite. Duhesh të studiosh diçka konkretisht që e ki naj hajr". Çka? Shkencat shoqërore më interesonin, juridik a, ekonomik a... Shkova në Prishtinë pyeta, thashë, "Mos jom vonue me kalu?" Ishte shef i administratës nji vendas i imi, tha, "S'ka problem bjeri dokumentat të regjistrojmë". Ashtu që, prej '68-tës isha student i Fakultetit Juridik-Ekonomik në Prishtinë.

**Anita Susuri:** Po më intereson këtu se po ju ndërprej, '68-ta kanë qenë demonstratat. Qysh ka qenë atmosfera? Qysh e keni pa ju?

**Azem Vllasi:** Tash të tregoj. Unë kalova ne fakultet. Sa u vendosa pak, do shokë të anës tonë um pranunë në atë konviktin. Konviktet e studentëve, kanë qenë poshtë ku osht' tash Qendra Universitare, ajo pjesa ku janë fakultetet kanë qenë do, përpara ka qenë kazerma, përdhesa e me dhoma. U vendosa aty. Ishin festat e "29 Nëntorit" quhej. Po shkojmë te shpia. Niva prej do shokëve, thanë, "Diçka ka me ndodh". "Çka ka me ndodh?" "Do farë demonstrata". "Për çka?" "Për të drejtat tona". Unë posa kisha ardh prej Beogradit, nuk isha në rrjedha akoma. Erdha këtu për puhsim, ishin nja tri-katër ditë pushim,

ashtu i ra. Në mramje përmes valëve të Radio Prishtinës nieva kanë ndodhë do demonstrata. Atëherë informatat ishin të kufizuara. Dalke gazeta “Rilindje” m’doket, në Kamenicë s’di a vinte ndonjë ekzemplarë apo jo, Radio Prishtina, valët e Radio Prishtinës.

Me sa më kujtohet ne akoma televizion, s’ka pasë kush televizor, s’ka pasë. Baba jem në fshat e ka ble televizorin e parë në ‘69-tën. A demonstrata ka ndodhë. Kur u ktheva e pash njëfarë atmosfere nervoze mes studentëve, do debate, “Kanë ndodhë demonstratat”, “Çka u kërkua?” Dikush tha, “U kërkua republikë”. Por atëherë ishte, ishin aktuale debatet për do ndryshime kushtetuese, sepse prej ramjes të Rankoviçit<sup>1</sup> nga pushteti prej vitit 1966 fillun në Jugosllavi do reforma ekonomike me synim të decentralizimit të pushtetit federal dhe të fuqizimit të njësisve federale me kompetenca ma të mëdha.

Kosova ishte krahinë, ‘Rreth i krahinës së Kosovës’, s’di qysh e qujshin dhe këtu ishte debati për avancimin e pozitës kushtetuese edhe të Kosovës në valën e atyne ndryshimeve kushtetuese. Kishte pasë ide, nuk ishte ajo kurrfarë teme e ndalume në debate publike. Dikush, “Po pse mos m’u bo Kosova Republikë?” Nuk ishte në pyetje Jugosllavia si tërësi, por statusi i Kosovës në aspektin e pavërsimit nga Serbia. Dhe si zakonisht që ndodh, rinia jonë ma radikale në kërkesa, kishte pasë edhe kërkesa të tilla, por ambienti i përgjithshëm, atmosfera e përgjithshme në Jugosllavi nuk ishte që të lejohet një hap i tillë dhe ai nuk varej krejt prej dëshirave tona.

Diku ishte për 29 nëntor, ishte njëfarë kremte, më doket ishte 25 vjetori i asaj Asamblesë të AVNOJ-it, në Jajce, 1943 kur jonë vu themelet e Jugosllavisë në baza federative.

**Anita Susuri:** “*Dan državnosti*” [srb.: Dita e shtetësisë].

**Azem Vllasi:** Po i thojshin “*Dan državnosti*” dhe dikush prej gazetarëve e pytë Titon, “Çka ka ndodhë në Kosovë? A e dini? A keni koment?” Tita nuk e boni t’madhe atë punë, tha, “Ka pasë trazira. Rinia i kanë shpreh do paknaqësi t’veta, por udhëheqësia e Kosovës i kqyr ato punë, e qetëson gjendjen”. Dhe ajo pastaj nuk u bo e madhe, nuk pati represion siç kishte mandej mas ngjarjeve të, ‘81-ta ishte diçka tjetër... dhe vazhdoi jeta normale.

Në ‘69-tën mu më zgjedhën kryetar të Lidhjes së Studentëve të Kosovës sepse ishin disa shkolla të nalta në Prizren, Gjakovë, në Gilan akoma m’doket jo, këto Fakultetet e Prishtinës. Mandati i kryetarit të Organizatës të Studentëve ishte një vjet, nuk janë aty për të bo karrierë politike dhe ajo çka ishte që mburrna me atë kohë sa isha kryetar i Lidhjes së Studentëve, ra ngjarja e madhe, themelimi i Universitetit të Prishtinës në vitin 1970.

Domethonë, nuk ishin mo Fakultetet, Universitetet e Beogradit, por ishte përveç Universitetit të Lublanës, Zagrebit, Beogradit, Sarajevës dhe Shkupit edhe Universiteti i Prishtinës. Ajo ishte një

---

<sup>1</sup> Aleksandar Ranković (1909 – 1983) – figurë e lartë politike jugosllave, zëvendës-president i ish-RSFJ-së. Në vitet 1950-1960 ishte në krye të organeve të sigurimit të shtetit në Jugosllavi.

ngjarje e madhe, shënonte një progres të madh të Kosovës, pikërisht në valën e atyne ndryshimeve që çonin kah avancimi i Kosovës.

Harrova të thom, në valën e atyne ndryshimeve kushtetuese, Kosova e kishte aktin ma të lartë juridik në vitin 1969. Statutin e krahinës Kosovë Metohisë as vet s'e di, kom qenë tepër i ri, qysh i thonin. Në '69-tën u aprovu Ligji Kushtetues dhe u ndrru emri i Krahinës Socialiste Autonome, Krahinës Autonome të Kosovës. Në vitin 1974 kur u pëmrbyll ajo seri e ndryshimeve kushtetuese u aprovu Kushtetuta e re e Jugosllavisë. Kushtetutat e reja të republikave dhe dy krahinave, kur Kosova dhe Vojvodina e fitoi kushtetutën e vet dhe statusin e ri, praktikisht të Njesisë apo Elementit Konstitutiv të Federatës sepse prej asaj kohe Kosova përfaqsohej në organet e Federatës me numrin, me kuadrat e veta, me përfaqësuesit e vetë drejtpërsdrejti, e jo nëpërmes Serbisë.

Por t'i kthehem kësaj, themelimi i Universitetit ishte një ngjarje e madhe që shënonte progresin e Kosovës, progresin në të gjitha lamitë, pra edhe në sistemin e arsimit si bazën kryesore për progres të përgjithshëm. Unë i përfundova studimet... po (qesh) të them edhe këtë. M'kaloi ai mandati njëvjeçar si kryetar i Lidhjes së Studentëve dhe Kosova avansonte edhe në nivel federativ me linja të caktume. Lidhjen e Studentëve të Jugosllavisë kishin në kryesi përfaqësues të vet organizata të studentëve të republikave dhe krahinave.

Në kryesinë e Lidhjes së Studentëve të Jugosllavisë si përfaqësues i Kosovës, unë masi që kisha qenë një vjet kryetar i studentëve të Kosovës, m'propozunë dhe m'caktunë prej Lidhjes së Studentëve të Kosovës mua. Isha nja një vjet atje. U ktheva se studimet akoma nuk i kisha mbaru, dhe në vitin 1973 diplomova. Masi diplomova, planet e mia jetësore ishin ta mbaroj ushtrinë. Shërbimi ushtarak ishte i obligueshëm. Pastaj planifikonim formimin e familjes, martesë, puna, e tjera (buzëqesh).

Por, ishin... po, na e kishim vendin tonë edhe në udhëheqësinë e Organizatës të Rinisë të Jugosllavisë, të gjitha republikat dhe dy krahinat sikur edhe në organet tjera. Masi që isha veç i afirmum nëpërmes Lidhjes së Studentëve dhe më njihnin edhe në Beograd dhe në pjesë tjera të Rinisë së Studentëve të Jugosllavisë nga koha që isha një vjet në Lidhjen e Studentëve. Nga Kosova më propozunë që unë të jom përfaqësues i Kosovës.

Hajt thash t'i ndryshoj planet, ta shtyj edhe pak afatin ndoshta pak edhe një vjet e planet tjera jetësore, martesë e tjera. Masi shkova atje m'u dha rasti në ndarjen e funksioneve në nivel të Federatës në zgjedhjet e përgjithshme që ishin në vitin 1974. U zgjedhën delegatët e Kuvendit Federativ. Kosova i kishte 15 vende në Dhomën Federative, tetë në Dhomën e Republikave dhe Krahinave. Ato u kryenë.

U zgjedh Qeveria Federale që i thonin atëherë, Këshilli Ekzekutiv Federativ. Kosova e kishte përfaqësuesin, a po m'doket dy përfaqësues. Në kryesinë e Jugosllavisë ku kishin të gjitha republikat edhe krahinat nga një. Ne e kishim, që ishte Fadil Hoxha edhe rinia ashtu mbeti. Kur shtrohet pyetje e kryetarit të rinisë, të Organizatës të Rinisë të Jugosllavisë, kryetar i Komitetit Krahinor, se atëherë

Mahmut Bakalli në nivel të kryesisë, se u pytke partia atëherë edhe për... Thotë, “Ne e kemi një kandidat. Nëse ju doket që si Kosovë po kërkojmë shumë e kemi kandidat Azem Vllasin”. Këta thojnë, “S’ka problem, le t’bohen konsultimet në organizatat e rinisë në republika e krahina, që i përkrahët s’ka problem”.

Unë pata përkrahje dhe prej vitit 1974, në nëntor kur u mbajt Kongresi i Organizatës, i Lidhjes të Rinisë të Jugosllavisë unë u zgjedha kryetar i Lidhjes të Rinisë të Jugosllavisë. U bonë do ndryshime, ndryshoi edhe emri, u qujke Lidhja e Rinisë Socialiste të Jugosllavisë. Ishin mandatet dy-vjeçare për rini. U zgjedha për një mandat dy-vjeçar, por në atë kohë erdhi ajo koha e fundit për shërbimin ushtarak, ashtu që nja dhjetë-njëmbëdhjetë muaj prej mandatit të parë i shpenzova duke e kry shërbimin ushtarak (buzëqesh).

**Anita Susuri:** Po më intereson si kryetar i rinisë çfarë përgjegjësi keni pasë, çfarë aktivitete janë bo?

**Azem Vllasi:** Aktivitetet kanë qenë të llojllojshme, prej aktiviteteve politike, kur kishte do debate do për tema të randësishme politike, u kyçshin në debate publike segmente të dryshme të shoqnisë edhe Organizata e Lidhjes të Rinisë u kyçke në ato debate. Lami tjera, aktivitetet shoqënore, zbavitëse të Kongresit të nontë të Organizatës të Rinisë, përputhet edhe me kohën kur u zgjedha unë u bonë si pjesë, anëtarë i Organizatës të Rinisë edhe organizatat e artistëve, organizata e sportistëve dhe organizata tjera.

Ashtu që, prej aktiviteteve kulturore, sportive, zbavitëse, edukative, pjesëmarrja në debate politike në krejta ato rrjedha ishte Organizata e Rinisë. Nuk kishim pushtet na, pushtetin e kish tjetërkush, ama dëgjohej zëri i rinisë i shprehur në mënyrë të organizume nëpërmes Organizatës të Lidhjes të Rinisë Socialiste të Jugosllavisë.

**Anita Susuri:** Edhe po më intereson si studentë sa keni qenë, për këto aktivitetet kulturore për shembull, për jetën kulturore po më intereson ma shumë me ditë.

**Azem Vllasi:** Në secilin nivel Organizata e Rinisë praktikisht ka qenë Organizata e Lidhjes të Rinisë Socialiste. Organizatore kryesore e manifestimeve të ndryshme kulturore, ka pasë nivele lokale, nivele republikane apo krahinore. I kemi pasë do manifestime në nivel federativ. Thojshin disa, t’rralla bartëse e atyne aktiviteteve ka qenë Organizata e Rinisë praktikisht.

**Korab Krasniqi:** A të kujtohet në ‘75-tën Titoja e viziton Prishtinën? A po ju kujtohet diçka prej asaj kohe?

**Azem Vllasi:** Po, m’kujtohet. Po, m’kujtohet. Isha kryetar domethonë në atë kohë prej ‘74-tës, isha kryetar i Lidhjes të Rinisë Socialiste të Jugosllavisë dhe si kuadër i Kosovës që isha në Federatë edhe

kosovarët, shqipëtarët tjerë që ishin në ato organizata për atë rast na ftunë në Prishtinë që të jemi gjatë vizitës të Titos. Besoj që nuk e ngatërroj kohën, ai ishte në atë vit kur Tito...

**Korab Krasniqi:** Në prill.

**Azem Vllasi:** Prill po, prill po por kur u shpall Titoja rektor nderi i Universitetit të Prishtinës, në atë ngjarje isha në takim me aktivin politik {përshkruan me duar} për kuadrat që i pati Titoja. Në Brezovicë do të thotë kam qenë. Atëherë prezent gjatë vizitës të Titës si kuadër i Kosovës që isha në Beograd në Organizatën e Rinisë e që na thirrën në Kosovë për atë rast të jemi aty. Ka pasë m'kujtohet edhe sot, dikun sillet kajherë ai fjalim shumë përmbajtësor në Brezovicë para aktivitet politik, ku ka folë edhe për nevojën e marrëdhajeve të mira me Shqipërinë.

Titoja në raport me Shqipërinë ka pasë konsideratë se në Kosovë jetojnë shumica shqiptarë. Shqiptarët janë praktikisht një popull i ndamë me një kufi, madje me një kufi të hekurt për shkak të regjimit çfare ka qenë në Shqipëri. Diferencat ideologjike në mes dy sistemeve kanë qenë të mëdha, por sidomos mas ngjarjeve të vitit 1968 që mahet në mendje si intervenimi i bashkimit sovjetik kundër tendencave të liberalizimit Çeko-Slllovak, por edhe Shqipëria edhe Jugosllavia u gjetën para një rreziku potencial dhe erdhi deri te një përmirësim i marrëdhajeve.

Pastaj ato marrëdhaje të mira, të përmirësime, jo shumë të mira në planin politik ndërshtetënorë nuk ka pasë raporte të mëdha por ka pasë plane ndëruniversitar, literatura, profesorërt, anej-knej. Ai fjalim i Titos në Brezovicë edhe sot është aktual, gjindet. Me përcjellë, Titoja ka qenë përkrahës i avancimit të pozitës kushtetuese të Kosovës edhe të shqiptarëve, sepse në konceptin dhe filozofinë e tij politike si lider i kontestushëm i Jugosllavisë që ishte, ka qenë që barazia e kombeve, se Jugosllavia ishte një shtet i rrallë aq multietnik, multikulturor, multigjuhësor dhe vetëm një masë e barazisë të të gjithëve mund ta runë stabilitetin e brendshëm.

Titoja ka ndihmu esencialisht që pozita e dy krahinave, e Vojvodinës dhe e Kosovës të avancohet gati në nivel si republikat, përveç emrit që ju ka mungu me qëllim që Serbinë ta bjen me njëfar barazpeshe me republikat tjera e mos t'ju rrin karshi Serbiave tjera si ma e fuqishme e ato kinse si ma të dobta. Serbia ka qenë tejet e paknaqun me Kushtetuten e '74-shit pikërisht për faktin se patë avansu pozita kushtetuese e krahinave. Serbët thojshin, "Çka po metë Serbia?" Po Serbia po mbetë çka janë republikat tjera, Serbia pa krahina, po do kompetenca fromale patën metë të krahinave përbrenda Serbisë, por ajo ishte diçka tjetër.

Domethonë, e maj n'menë atë vizitën e fundit të Titos që ishte në vitin 1979, në tetor. Ajo ishte vizita e fundit e Titos dikund në terren nëpër Jugosllavi. Pastaj u smu dhe në 1980 vdiq.

*[Këtu ndërprehet intervista]*

**Korab Krasniqi:** E prej '74-tës...

**Azem Vllasi:** Tash tregoj... Unë u ktheva prej Beogradit, m'kaloi mandati i dytë dy-vjeçar i kryetarit i Organizatës të Rinisë së Jugosllavisë, që isha prej vitit '74-'76 dhe '76-'78. U ktheva në Prishtinë. Thanë, "Zgjedhjet kanë kalu në pranverë, nuk kemi vend për ty". Thashë, "S'po m'intereson mu vendi. Unë jam jurist, po punoj në sistem gjyqësor. Mahmut Bakalli tha, "Jo, jo, s'bon". Tha, "E mendojnë që diçka duhesh me punu" edhe kish metë një vend, sekretar i organizatës i thojshin i Lidhjes Socialiste e Popullit Punues të Kosovës. Kryetar ishte një malezëz i Pejës, Mihajllo-Misha Svircer.

Mu qaty sekretar, por ajo nuk ishte najfarë vendi, ashtu që me protokol mu nuk m'ka taku të jem afër aty ku ishin bisedat gjatë vizitës së Titos në '79-tën. Por, kështu kom qenë {përshkruan me duar} në disa vende *uuu* {onomatope} kështu me pritë, por në afërsi s'kom qenë sikur në vitin 1975. Në Grand, në Hotel Grand u patë vendosë. Na s'kishim naj shtëpi rezidenciale. Jonë konë njo dy qaty para Grandit, në Grand, mirëpo në afërsi të Titos, me udhëheqësit tjerë kosovarë në '78-tën nuk kom qenë sepse funksioni jem ishte...

**Anita Susuri:** Qatëherë kur ka ardh Titoja a të kujtohet qysh ka qenë qyteti ose qysh e kanë pritë? Qysh u konë krejt atmosfera?

**Azem Vllasi:** Unë e maj n'men... po shumë mirë. Unë e maj n'mend edhe vizitën e Titos në 1967, ishte vizita e parë e Titos në Kosovë mas ramjes së Rankoviqit nga pushteti. Shqiptarët ja nisën me marrë frymë lirëshëm dhe e dijshin që Titoja e ka hjek Rankoviqin prej pushtetit, se kërkush s'kish mujtë tjetër dhe si në shenjë falenderimit edhe gjatë asaj vizitës të '67-tës ka qenë një pritje madhështore. S'ka kurrëfar organizimi aq në mënyrë që i detyron njerëzit, por dulën me pritë Titon me të vërtetë.

Unë isha si nxanës i gjimnazit këtu. Një grup, "Hajde në pritje". Shkumë me autobus qatje në masë {përshkruan me duar}. Kemi qenë, e ka majtë një fjalim Titoja afër komunës që osht' ajo përmendorja trekandëshi [Përmenderja Vllaznim Bashkim]. Ka qenë një pritje madhështore, si çdokund ku shkonte në vizitë nëpër Jugosllavi Titoja.

Në '75-tën poashtu është pritë, është pritë shumë mirë nga njerëzit. Nuk ka që me thonë i ka organizu dikush se njerëzit s'mundesh m'i shti masovikisht me zor me duartrokitë e me qeshë. Domethonë, si çdokund ku shkojke nëpër Jugosllavi qashtu u pritë Tito edhe në Kosovë gjatë të tri këto vizita që i maj n'menë unë.

**Pjesa e Dytë**



**Anita Susuri:** Paraprakisht, para se me vazhdu me atë periudhën që e lamë tek ushtria, po më intereson edhe pak në Prishtinë qysh ka qenë ajo, thatë për argëtimin, jetën argëtuese, kulturore? Ka pasë teatro, ka pasë kinema. A i keni vizitu këto? Qysh ka qenë?

**Azem Vllasi:** Unë mund t'ju them m'kujtohet edhe jeta kulturore e Prishtinës në atë kohë deri dikun në vitet 1978-'79 sa e kishim atë autonominë. Tonë m'kujtohet për mos të thom gati me nostalgji. Jonë bo disa filma t'mirë. Kemi pasë artista me renome botënore, jugosllave po se po. Bekim Fehmiu ka qenë artist jo vetëm i Kosovës shqiptar, por i Jugosllavisë i njohun jashtë. Ka qenë Abdurrahman Shala, ka qenë Istref Begolli, Faruk Begolli, shumë të tjerë, Melihate Qena.

Ka pasë pjesë teatrale fenomenale. Janë bo disa filma që kanë qenë në festivalin e punës e lami të tjera. Ka pasë një jetë dinamike kulturore. Veprimtaria botuese ka qenë e zhvillume. "Rilindja" si gazeta ditore e botueme në gjuhën shqipe, ka pasë... mos po hi në gjyna nesë ja u zvogëloj veç ka qenë tirazhi ditor përmi 50 mijë ekzemplarë. Njerëzit kur dilnin te kiosqet p'e marrin "Rilindjen" me kqyr m'u informue. Botimi i librave, ka pasë revista, prej asaj revistës të famshme "Jeta e Re" që ka qenë kryeredaktor Esat Mekuli i madh.

Kemi pasë njerëz me emra, akademik. Rektor të universitetit prej rektori i parë ka qenë Dervish Rozhaja i ndjeri, doktori i shkencave ma i ri në Jugosllavi atëherë prej shkencave biologjike. Idriz Ajeti, Gazmend Zajmi, kanë qenë njerëz me të vërtetë me peshë, me bagazh shkencor, në shumë lami tjera. Ne domethonë në vitet mas '66-tës, mas debllokimit si të thom të jetës politike, shoqënore në Kosovë sepse në '66-tën pushtet faktik mbi Kosovën e mbi shqipëtarët ka qenë UDBA<sup>2</sup>. Komitetet partiake kanë qenë qaty, por mas '66-tës fillon një jetë dinamike në të gjitha lamitë shoqërore, që u shënu një progres i madh dhe ato janë deri në '89-tën.

Është një periudhë për kushtet e atëherëshme mund të them e artë e Kosovës. Kur flitet për zhvillimin ekonomik, Kosova gjithmonë ka qenë në krahasim me pjesët tjera të Jugosllavisë, si pjesa ma e pazhvillume. Por ishte atëherë një mekanizëm, ka qenë një Fondi i Federatës për Viset e Pazhvillume, prej atij fondi sa u grombullojshin pare, Kosova si vendi ma i pazhvillum i merrke ka 82 përqind të mjeteve.

Me një politikë të përgjithshme në nivel federal, vendet ma të zhvillume, firmat e vendeve ma të zhvillume ndërtojshin kapacitete t'vetat në Kosovë, punësojshin njerëzit. T'gjitha këto qytetet, se qytetet ma t'mëdha në... Kosova kanë pasë industri të konsiderueshme, fabrika. Domethonë, ka qenë një kohë edhe e progresit dhe zhvillimit ekonomik i konsiderushëm. Universiteti i Prishtinës diku ka vitet '75, '76 ka qenë me numrin e studentëve, universiteti sa m'kujtohet i treti në Jugosllavi mas Universitetit të Beogradit dhe Zagrebit.

---

<sup>2</sup> UDBA- Shërbimi i Sigurimit të Shtetit, i njohur gjithashtu me emrin e tij origjinal si Administrata e Sigurimit të Shtetit, ishte organizata e policisë sekrete të Jugosllavisë gjatë viteve 1946-1991.

Po masi kishte Jugosllavia shumë njerëz, profesorë, me tituj akademik, kanë kry studimet, doktoraturat, kanë bo karrierë akademike në Universitetin e Beogradit, të Zagrebit posaqërisht se diqysh marrëdhjetet ma ndryshe i kemi pasë me Zagrebin. Kanë qenë njerëzit e botës akademike që hiç që thojnë s'ja u kanë lëshu rrugën, kanë qenë në nivel të kolegëve të tyre në Beograd, Zagreb, në vende tjera të Jugosllavisë.

Kur ju flas kështu dikush thonë, "Paska nostalgji për..." S'kam nostalgji për, s'kam unë nostalgji as për Lidhjen e Komunistëve, as për ideologji, as për Jugosllavi çfare ishte, se mënyra qysh e shkatërrunë serbët na gërditën krejtëve. Por, po flas për një realitet që jom dëshmitar i asaj kohe, madje jo kështu si vëzhgues, qytetarë i thjeshtë, por kom qenë qaty {përshkruan me duar} në rrjedha.

Unë kam qenë siç ju thashë në atë kohë kur ishin debatet para aprovimit të Kushtetutës në vitin 1974 në rini edhe na rinia siç ju thashë u kyçshim në debate publike. Hala nuk isha kryetar, por anëtar i Kryesisë të Rinisë të Jugosllavisë prej '73-tës. Në nëtor të '74-tës u zgjedha kryetar. Ishmi të kyçyn në ato debatet kushtetuese. Unë i kom pa për së afërmi kundërshtimet e Serbisë për avansimin e pozitës të Kushtetutës. Na qysh ishim rini ma të relaksum kaniherë bonim shaka.

Përfaqësuesit e Vojvodinës edhe ne i thojshim ktyne të Serbisë, thojshin, "Mirë, po çka po mbetet Serbia? S'po mbetet. Serbia nuk o si republikat tjera me dy krahina". Na ju thojshim, "Ani mirë, nëse doni Serbia të bohet taman si republikat tjera atëherë leni krahinat. Tjerat republika nuk kanë krahina. (qesh) Nuk do të keni as ju edhe do të jeni të barabartë (qesh)".

Atëherë i kom pa pretendimet e serbëve. Në 1976, akoma isha kryetar i Rinisë, në Serbi i hinën me bo një analizë me tregu qysh nuk po funksionon Serbia qysh duhet, se dy krahinat jonë pavarësu shumë dhe tash me rikthy debatin prapë për pozitën e krahinave, gjegjësisht për një lloj rikthimi ma të fuqishëm të krahinave nën juridiksionin kushtetues të Serbisë. Na t'krahinave edhe këta të Vojvodinës, absolutisht kanë qenë plotësisht mbrojtës të pozitës kushtetuese të Vojvodinës që s'bon ma mirë, kanë kundërshtu.

Unë isha në [Organizatë] Rini atëherë, këtu ishin tjetër kush. U takojshim në Beograd me kuadrat tonë në ato mledhjet me Mahmut Bakallin, me këta tjerët që i kanë kundërshtu. Kur ka shku ajo iniciativë te Titoja, Titoja ka thonë, "Ndryshimet kushtetuese kanë përfundu, e kemi Kushtetutën e re të '74-shit. Nëse diçka nuk funksionon në praktikë, kqyrni ju merruni vesh çka duhet me funksionu në praktikë ma mirë edhe në raportet në Serbi me krahinat, por ndryshim të Kushtetutës nuk ka".

Prandaj, duke i ditë ato pretendime të Serbisë na që i dinim se kemi qenë ma afër ngjarjeve, rrjedhave dhe udhëheqësit e atëherëshëm jemi friku... Serbët tani e lanë atë punë masi po thotë Tita, "S'bon, s'bon!" Naj ditë tjetër, naj kohë tjetër. Në '74-shin Titoja i kishte 84 vjet dhe mas vdekjes së Titos kur ndodhën ngjarjet në Prishtinë, pa marrë parasysh entuziazmin, vullnetin, dëshirën që Kosova të jetë krejtësisht e pavarun nga Serbia si republikë, si republikë.

Por ne kishim frikë se pa Titon të kthehet ajo bumerang edhe të gjenë Serbia edhe një shkas për t'i rikthyer ambicjet e veta ndaj, ndaj krahinave. Deri në '88-tën, '89-tën na i gëzum frytet e atij hovi që i kishim prej '66-tës, '67-tës e këndeje. Sa po i bjen? Nja 15 vjet. Për atë kohën e Jugosllavisë mujmë me bo be, "Pasha qato 15 vjet". Tani prej '89-tës, '99-tën faktikisht ishte koha e një okupacioni të vrazhdë të Serbisë dhe në '99-tën ndodhi çthurrja e madhe, sa po i bjen, 70 vjet, a 80 vjet.

Prej vitit 1912 kur ka hi Serbia me dhunë në Kosovë mas përfundimit të epokës otomane në këto treva deri në '89-tën. Prej '89-tës, në '99-tën një okupacion klasik në '99-tën erdhi. Mas 80 vjete erdhi. Mas 80 vjetëve erdhi e për ato 80 vjet e kishim njëfarë drite në qatë periudhë që ju spjegova prej '66-tës deri '89-tën.

**Korab Krasniqi:** Në '86-tën ndodh kjo, meqë ishit t'u folë për krahinat, ndodh kjo që e qujshin për Revolucionin e Jogurtit<sup>3</sup> në pjesën e Vojvodinës. A mundesh pak me na spjegu për këtë pjesë?

**Azem Vllasi:** Po, po, domethonë në Serbi ja nisen... kështu ishte puna që filloi krejt ajo edhe qysh filloi ofanziva e Serbisë kundër pozitës kushtetuese të dy krahinave. Në vitin 1986 kryesia e Jugosllavisë që ishte kompetente me Kushtetutë e nisi një iniciativë për disa ndryshime në Kushtetutën e Jugosllavisë, ama ndryshime në sferën ku rregulloheshin raportet ekonomike me qëllim që të hapen mundësi për reforma ekonomike.

Serbët u kapën aty thanë, "Masi ndryshime kushtetuese nuk ndodhin përditë, hajde ta shfrytëzojmë qatë rast e ta kyçim edhe një pikë edhe një temë të debatohet raportet në Serbi me dy krahinat që t'bohen do ndryshime. Ne nga të dy krahinat kundërshtonim se e dijshim ku e kanë qëllimin serbët. Veç të nisët ajo temë, hec e nale! Thojshim, "Aty s'ka çka preket. Ajo osht', ato raporte janë të rregullume me Kushtetutën e '74-tësm a kjo për reforma ekonomike bohet në tonë Jugosllavinë edhe n'rregull".

Serbët insistunë de se de, na jo se jo dhe mbeti njëherë jo se jo. Kryetar i atij këshilli kordinues në nivel federal ishte anëtar i kryesisë nga Bosna, Hamdia Posderac edhe ishte mik i yni përkras edhe ishte mik i imi personal, kisha raporte të mira. Unë isha kryetar i Komitetit Krahinor. Ai tha në atë propozimin, "Le t'hin çka po thojnë serbët vetëm si temë për debat". Thojsha, "Hamdia mos se hin vetëm si temë për debat. Tu e çelë derën pak me shty brylin na s'mujmë i nalim këta".

Por sidoqoftë, kur filloi në debat, qaty u nis puna, serbët e aktualizunë temën. Raportet në Serbi, raportet në Serbi me krahina. Na të dy krahinat thojshim, "Aty janë vijat e kuqe". Që po i përmenin tash do vija të kuqe. Vija e kuqe ka qenë qajo, pozita kushtetuese e Kosovës edhe ata të Vojvodinës thonin, domethonë të dy, "Nuk prekët!"

---

<sup>3</sup> Revolucionin anti-burokratik (Jogurt Revolucionin) ishte një fushatë protestash në rrugë nga mbështetësit e udhëheqësit serb Slobodan Milosheviq që u zhvillua midis 1988 dhe 1989 në Jugosllavi.

Erdh Millosheviqi në pushtet. Nacionalizmi serb praktikisht u legalizu se në '86-tën mos të harrojmë doli ai memorandum i Akademisë të Shkencave që praktikisht ishte platformë për ridizajnimin e Jugosllavisë të atëhershme. Nën një, krijesë si Serbi e zgjenume apo Serbi e Madhe. Memorandumi vajtonte pozitën e fshtirë të serbëve, kishe çdokund ku jonë [me vendbanim] dhe pozitën e Serbisë sepse i ka dy krahina. Sidomos vajtohej pozita e vështirë e serbëve në Kosovë, sepse shqiptarët prej masi kanë pushtet me autonominë kushtetuese që e kanë dhe Millosheviqi me ambicje që të bëhet një lider i vërtetë, praktikisht e murr si për bazë si platformë të veprimtarisë të vet politike memorandumin e jo programin e Lidhjes të Komunistëve të Jugosllavisë dhe Kushtetutën legale në fuqi.

Masi që me kështu me debat publik absolutisht nuk arritën të na bindin neve edhe vojvodinasit, atëherë ja nisën me mitingje, me politikë në rrugë me presione. E këtu në Kosovë ja nisën m'i organizu do serbë në Fushë Kosovë se qaty ishin me bo zhurmë, me bo protesta m'u anku kinse për pozitën e vështirë të tyre, kinse udhëheqësia e Kosovës nuk është e kujdesshme për ta, po ikin, po shpëngulen nga presionet e nacionizmit shqiptar e tjera, e tjera.

Kur debatojshim në nivel federal në Kryesinë e Komitetit Qëndror të Jugosllavisë unë ju thoja, "Shiqoni, këto mitingje, këto jonë krejt të kudisuna, jonë presion për ndryshimet kushtetuese që po i synon Serbia". Thojsha, "Ju e dini që këtë synim e kanë të mahershëm, por tash po donë n'këtë mënyrë". Vojvodinasit po ashtu mbaheshin mirë, mirëpo në Vojvodinë me mitingje i organizojnë një miting të madh në Novi Sad me autobusa jo vetëm prej Vojvodinës, prej vendeve tjera në Serbi {përshkruan me duar} ju vijnë një ditë në dritare udhëheqësisë, atë lëvizje jau, jau hupnin serbët asaj lëvizjes të mitingjeve do emra ekzotike, i kanë gju atje me jogurta dritaret e selisë të pushtetit të Vojvodinës. E qujshin, "Jogurt Revolucija", Revolucioni i Jugurtit.

Ata të shkretit u dorëzunë, dhanë dorëheqje edhe u avancunë idhëtarët e politikës të Beogradit. Në Vojvodinë ishte lehtë sepse Vojvodina atje ishte lehtë, se atje shumica e popullatës kanë qenë serbë, përmi 70 përqind. Te ne tentonin në të njejtën mënyrë, por te ne me mitingje nuk i shkonte sepse serbë pak, shqiptarë shumë. Me ardhë serbë me autobusa prej Serbisë frikësoheshin mos po vjen deri te {përshkruan me duar} konfliktet fizike. Kundër nesh shkunë në tjetër mënyrë, por ajo storje tjetër. Kalojmë në ato gjithsesi.

**Anita Susuri:** Deshta me kalu te një tregim i juji ma subjektiv për... tregutë që keni shku në ushtri. Pastaj pas ushtrisë si ka ndodhë avancimi politik krejt, krejt këtu? Pastaj pozita si kryetar, por ajo është pak ma vonë.

**Azem Vllasi:** Domethonë, unë në nëntor në vitin 1974 më zgjedhën kryetar me pëlqimin e organizatave dhe të gjitha republikave dhe krahinave. Kryetarët të Organizatës të Rinisë të Jugosllavisë thillum të punojmë. Dikun në maj vitin tjetër në '75-tën ishim në një bisedë unë me një delegacion të rinisë te Titoja. E informum për rrjedhat për Organizatën e Rinisë për një konsolidim se Organizata e

Rinisë kishte pasë një krizë përpara. Titoja na ndëgjoj, na priti mirë, na dha këshilla. Dy ditë masanej shkojnë te Titoja delegacioni ushtarak i mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes në krye me gjeneralin Nikolla Lubiçiq.

Masanej mu me një rast më tregon një prej delegacionit ushtarak që ka qenë kryetari i Organizatës të Lidhjes së Komunistëve në Armatë, një gjeneral boshnjak, Xhemill Sharac, kisha afërsi me to. Boshnjakët mu m' respektonin si dhondër të Bosnës (buzëqesh) edhe si Kryetar të Rinisë. Tha, "Ishim te Titoja. Na tha që kishit qenë ju dy ditë përpara nesh te ai", tha që këta të Rinisë më informun si po punojnë dhe mirë jonë t'u punue edhe Titoja s'kish kalu shumë kohë, s'ma kish majtë në mend emrin, "M' duket mirë po punon ky shqiptari i vogël". Na i tham, "Azem Vllasi", "Po, Azem Vllasi". Më erdhi mirë.

S'ka kalu shumë mas asaj kohe, unë e marr ftesën për me shku në shërbim ushtarak.

**Anita Susuri:** Veç para se me vazhdu aty, se po më intereson...

**Azem Vllasi:** Qaty po du me ardhë. (buzëqesh)

**Anita Susuri:** Kur keni shku te Titoja...

**Azem Vllasi:** Po.

**Anita Susuri:** Çfarë përgatitje ka qenë? Qysh jeni ndi? Qysh ka qenë ai takim?

**Azem Vllasi:** Sot e kësaj dite Nadirja, gruja jem thotë, "Ti kurgjo. Kur kishe me shku te Titoja disa ditë përpara në mëngjes u çojshë, e pijshim kafën, thojshë, 'Hajde po shkojmë në punë se sot në ora 11:00 kemi me shku te Titoja'. Kur u kthejsha", tha, "në mramje, besbile ishte tema". Unë pak i tregojsha, po kurgjo. Përgaditshmi me bisedu, m'i informu qysh po shkojnë, si osht' situata në Organizatën e Rinisë, te rinia, aktivitete, na i bojke do pytje, ju përgjigjshim. Dikush prej këtyne që ishim në delegacion me mue najsen folke. Titoja zakonisht shkurt. Naj sygjërim, najçka me thonë, kurgjo s'ka qenë e posaqme, as përgaditje të posaqme, as biseda të relaksume.

Por, unë me Titon kam pasë disa biseda të relaksume, kështu takime katër sy kur kom shku me vizitu. Por në Kongresin e fundit që ai s'mundte me ardh sepse ishte diçka prej ishiasit i smutë. Thashë, unë thashë, shefi i kabinetit, tha, "Informoje Titon", tha, "Se s'mundet me ardh". Kemi bisedu bashkë një herë. E kom taku në Brionë, i kom pasë disa raste, kom fotografi qaty.

*[Këtu ndërprehet intervista]*

**Azem Vllasi:** Në Prishtinë e pata lonë, ka qenë i ndjeri gjenerali Adem Reçica, shef i mbrojtjes popullore të Kosovës. I pata thonë, "Gjeneral"... që kojshin, jo masanej, thashë, "Unë tash në atë detyrë

të re duhet me ja nisë me punu në atë afatin ligjor e kom deri në nëntor, nëntor '75-tën dhe kur të m'vjen koha atëherë s'mujshje veç me shërby në qytetin prej nga je. Unë jom nga Prishtina, domethonë mundeni me ma çu thirrjen me shërby në Beograd sepse dy kryetar të Rinisë para meje i ka kap shërbimi ushtarak gjatë mandatit por kanë shërby në Beograd, slloveni Jazen Kociançiq edhe një i Vojvodinës ka qenë para meje Vladimir Maksimovic". Gjenerali Reçica tha, "N'rregull, s'ka problem".

Mas qisaj bisedës që tregova që kanë qenë delegacioni ushtarak te Titoja dhe e kanë pa çka po mendon Titoja për mu, gjenerali Rrustem Reçica m'thërret, thotë, "Azem", thotë, "kqyre na atë afat do ta çojmë thirrjen ty", por thotë, "sun ta maj fjalën qysh jemi marrë vesh". Thashë, "Çka u bo?" Tha, "A e din te na osht' ligji komandues. Mu", tha, "prej Beogradit, domethonë kur m'kanë vetë prej gjeneral shtabit Lubiqiqi. Kur, qysh qëndron puna me afatin ushtarak për ty". Ju kom tregu që ka kohë hala. "Ku doni me çu?" "Paj me ditë, në Prishtinë jo se ai o i Prishtinës. Në Beograd mos e çoni. Çoni dikund larg", tha veç ta dishë mos t'i bjen që t'kom pre në besë. Thashë, "E kuptova gjeneral qysh janë ato raporte" dhe mu ma çunë një thirrje dikund në Slloveni qatje afër Lublanës.

Por unë e shfrytëzoj rastin masi kisha afat hala, një herë në një mbledhje të kryesisë të Komitetit Qëndror ku kishin thirrë këta funksionarët tjerë edhe mu si kryetar të Rinisë, e takoj gjeneralin dhe i zateta, thom, "Kqyra çka m'ka thonë gjenerali Adem Reçica që duna me shku ushtar". Thash, "Unë kom kohë. Hala jom në afat. Ja kemi nisë me punu, qitash jom zgjedh qe gjashtë muaj". Tha, "Ani, ani pra me shty pak bon por duhet me shku dikund ma larg". Thash, "Po s'di pse o kijameti me shku larg. Çfarë osht' ajo? Dy para meje kanë shërby...", "Po, po, qeshtu ju rinia p'e keqpërdorni e duhet me shku dikund me shërby si shembull". Thashë, "Unë ku t'shkoj me kry shërbimin ushtarak, unë s'bohna mendjemadh shërbej si shembull, s'ka problem". "Po", tha, "qe ta shtyjmë pak".

E shtynë e nuk m'çunë në Slloveni, por e shtynë gjashtë muaj e m'çunë në një vend edhe ma t'zi, në Bileq qatje në Hercegovinë, ku dreqi s'bon vo. Se qatje u konë shkolla e oficerëve, oficerëve rezervë ushtarak. Kur e kryjsha atje afatin ushtarak edhe atë farë shkollë ishte njëfarë oficeri rezervë në civil. Kështu e kom kry atje ushtarinë në nëntor edhe pak tani masi e kreve shkollën atje shatë muaj, tre muaj, katër më metën në Tuzëll.

Kur u ktheva ishte kah fundi ai mandati i parë që m'kish kap shërbimi ushtarak edhe për mandatin e dytë me Statut të Rinisë kisha të drejtë edhe një mandat. Në Rini thanë, "Po more, pse jo!" Qashtu, isha në mandatin e dytë prej fundit në 1976-tën deri në fund të 1978-tën kur u ktheva në Kosovë.

**Anita Susuri:** Në '78-tën kur jeni kthy pastaj...

**Azem Vllasi:** Në '78-tën u ktheva në Kosovë, zgjedhjet ishin kalu, vendet, funksione diçka s'kish. Thashë, "S'ka problem, unë jom jurist, muj me punue në sistemin gjyqësor". Mahmuti tha, "Jo, nuk bon. Asi duhesh diçka me konë. E kemi qatë vend të shprazt, sekretar i Lidhjes Socialiste". S'ish gjo por thash, "Ani, mirë pra. S'ka problem". Tha, "Duhemi me ta dhonë një funksion se menojnë si të zhdukesh

krejt prej politikës... A ke qenë kryetar i Rinisë të Jugosllavisë me emër, mendon najkush që ki diçka kundër meje”, Mahmuti. “Mos u mërzit për këto, masi unë s’po mërzitna”, por mbeta qaty në Lidhjen Socialiste.

Tani kalunë kohë, ngjarjet, ndodhën ngjarjet e ‘81-shit e unë isha sekretar i Lidhjes Socialiste, domethonë as nuk isha anëtar i kryesisë të partisë, as anëtar i kryesisë të Kosovës. Kryetar ishte ai Misha Svirceri hale. Qaty ishëm. U ngatërru, situata politike u randu, situata e sigurisë. Opinioni jugosllav, kreu federal ishin të mllëfosun për ato ngjarje që ndodhën se ishin menu të gjithë në rahat, në kohën e Titos ndodhi ajo. Metën mas Titos në kreun partiak dhe shtetnor të Jugosllavisë do njerëz të vjetër të gjeneratës të partizanëve që ishin msu në rahat, menxi s’pritën që ndodhën ato ngjarje për t’i riaktivizu ato pretendimet e veta.

Atëherë u aplikun do mandate një-vjeçare, ka qenë një ide e Titos, “Mos t’rriren shumë në funksione njerëzit se po byrokratizohen, po byrokratizohet jeta politike. Në Kosovë kishin qenë ka dhjetë vjet në krye të atyne organeve. Ja nisën, ja nisi aplikimi i mandateve njëvjeçare. I kaloj mandati atij Misha Svircerit. Mu dikund në ‘82-tën më zgjodhën me një mandat një-vjeçar kryetar të Lidhjes Socialiste të Kosovës. Masanej isha kryetar i Komitetit Komunal të Prishtinës, dikun prej ‘83-tës deri në ‘85-tën. Prej ‘85-tës deri në ‘86-tën isha kryetar i Kryesisë të Komitetit Krahinor, ishte funksioni jem i pari partiak.

Në ‘86-tën më zgjedhën kryetar të Komitetit Krahinor të Kosovës. Në mandatin një-vjeçar u bonën njo plus njo mundet e qeshtu. Për vitet ‘85 e deri ‘89 gjendja në Kosovë u stabilizu, u kthynë në normalitet. Por problemin kryesor e kishim me Beogradin, gjegjësisht me udhëheqsinë e Serbisë. Vinin duke u ashpërsu marrëdhanjet mes nesh dhe udhëheqsisë të Serbisë pikërisht për fakt që ju tregova, për pretendimet e tyne që raportet në Serbi të ndryshojnë, pozita kushtetuese e krahinave të rrënohet.

Ja nisën me politikë nëpër mitingje. Erdhen duke u shtu presionet ndaj udhëheqsisë të Kosovës. Në ‘97-tën<sup>4</sup>, në ‘96-tën u zgjedh kryetar, unë u zgjedha kryetar i Komitetit Krahinor në prill ‘96-tën, në qershor i kaloj mandati atij Ivan Stambolliqit<sup>5</sup>. Në krye të Komitetit Qëndror të Lidhjes Komunistëve të Serbisë u zgjodh Slobodan Millosheviqi dhe Stambolliqi e shtynte ato, e avansonte. Nuk ishte ai shumë i njohun në opinionit politik jugosllav e as në Serbi qaj Millosheviqi, Ivan Stambolliqi e avansonte. Pak kështu hale Stambolliqi ishte lider i Serbisë.

I keqpërdorën gjithnji e ma shumë serbët e Kosovës. Të Fushë Kosovës bojshin mitingje, na trazojshin situatën, shkojshin në Beograd grupe të mëdha, ja u pagunin trenin, bonin probleme serbët e Kosovës para Organeve Federale dhe Republikane në Beograd kinse nuk po i mbron Federata dhe Republika. Ata në Kosovë prej presioneve të shqiptarëve dhe prej pakujdesisë kinse të udhëheqsisë të Kosovës në mirëqenjen e tyne që ishin krejt rrena. Ishte ajo një propagandë e sofistikume me qëllim të caktum.

---

<sup>4</sup> Në këtë pjesë folësi flet për vitet e ‘80-ta, por e ngatërron me vitet e ‘90-ta.

<sup>5</sup> Ivan Stambolić (5 nëntor 1936 - 25 gusht 2000) ishte politikan serb. Ai ishte anëtar i Lidhjes së Komunistëve të Serbisë i cili shërbeu si President i Serbisë në vitet 1980.

Kështu vazhdun, vazhdun presionet. Ishin ato gati në çdo të dytën mledhje të kryesisë të Komitetit Qëndror të Jugosllavisë ku unë isha atje anëtar si kryetarët e Komitetit Qëndror të Republikave dhe Krahinave ishin edhe anëtarë të kryesisë.

Kacafytje me Millosheviqin, ja manin krahin këta kuadrat, hajt t'ju thom profesorë të Malit të Zi ishin dy në kryesi. Këtu propaganda, serbët propagandonin, propaganda e Beogradit ishte kinse serbët e malazezët kanë presione prej shqiptarëve, po shpërngulen nga presionet, po vazhdmisht serbët edhe malazezët. Ndërsa kur u shkel autonomia kushtetuese, u vendos me dhonë këtu pushteti serb, mo qaj pushtet serb as që i përmene malezezët. Tash po e shohim në Mal të Zi atë tendencë që po thojnë, “Jo, malazezët jonë serbë” edhe mo u zhduken. Po ku janë malezezët? More thojshin, “Serbë jonë ata”.

Pse thojshit pra presioni ndaj serbëve dhe malazezëve? Që mu dokë që dy popuj janë nën presionin tonë edhe e kishin qëllimin me përfitu edhe përkrahjen e udhëheqsisë të atëhershme të Malit të Zi për presionin ndaj nesh. Ishin për shembull në kryesisë e Komitetit Qëndror të Jugosllavisë Boshnjak një serb, një Millan Korenovica i cili kur filloi lufta në Bosne, ai dul tani krah i Radovan Karagjiqit<sup>6</sup>, e kështu me rradhë.

Na ishim, maqedonasit, përfaqsesit e Maqedonisë i bonin shoqni Serbisë për presionin kundër nesh lidhur me Kosovën sepse në qatë mënyrë e kishim ma lehtë dhe në heshtje m'i shtyp shqiptatët në Maqedoni. Shqiptarët në Maqedoni ishin në hall prej pushtetit të vet maqedonas, a udhëheqësit maqedonas i përkrahshin qëndrimet dhe presionet e Serbisë ndaj neve kinse krejt për stabilizimin e gjendjes në Kosovë.

Nji herë unë dashta pak me ja u kthy topin maqedonasve, e dikund fola publikisht e shtrova çështjen e pozitës të vështirë të shqiptarëve në Maqedoni. Kur t'mu turrën nga udhëheqësia e Maqedonisë, tona organet atje majtën mledhje për ta gjyku atë fjalim temin dhe për të kërku që Komiteti Qëndror i Lidhjes të Komunistëve të Jugosllavisë ku isha anëtar si kryetar i Komitetit Krahinor të marrin masa ndaj meje. Unë thashë, “Ani, s'ka problem. Do ta hapim debatin e ta kqyrim a osht' problem me të vërtetë pozita e shqiptarëve në Maqedoni apo unë pasna fol palidhje, pasna trillu diçka. Nëse pasna trillu mund të merrna në përgjegjësi. Nëse kom folë për problemin real që e kanë shqiptarët në Maqedoni mund të flasim për problemin”.

Atje ishte një pauzë. Një mledhje, *shy-shy-shy* {onomatope} ndëgjojshim krejt. Millosheviqi ju thotë këtyne përfaqsesve të Maqedonisë, thotë, “Edhe ashtu pika e parë e rendit të ditës hupi shumë kohë e e leni këto propozimin që m'u diskutu për atë fjalimin që e ka majt Azemi se ju kthehet si bumerang”. A unë menxi pritsha, “Ja, ja, do të bisedojmë, t'i hapim letrat”. Kur u çu përfaqësuesi i Maqedonisë tha, “A din çka, jemi lodhë, zgjati debati për pikën e parë”, sdi çka ishte pika, situata ekonomike, “kështu që

---

<sup>6</sup> Radovan Karadžić (1945-) është një ish -politikan serb boshnjak i cili shërbeu si president i Republikës Sërbe gjatë Luftës në Bosnje, dhe më vonë u dënua për gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime lufte nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish -Jugosllavinë.



ky propozimi ynë që të diskutohet për përgjegjësinë e Azem Vllasit që ka folë asi p'e lojmë për tjetër herë”.

## **Pjesa e Tretë**

**Anita Susuri:** Në vitin '88 ju veç domethonë keni qenë nënkryetar. Po më intereson krejt rrethanat që ju kanë bo me ardh deri te ai vendim? Pastaj vazhdojmë me marshet që kanë qenë në Prishtinë.

**Azem Vllasi:** E kjo ka ndodh kështu. Domethonë, me statut ishte na ato mandatet një-vjeçare prej vitit '81, i pari kryetar me mandat një vjeçar Mahmut Bakalli për shkak të ngjarjeve që ndodhën e krejt me presione nga kreu federal se qashtu ishin raportet atëherë. Mahmuti shkoi me dorëheqje, por edhe ashtu dhjetë vjet gati kishte qenë, fillun mandatet një-vjeçare. I pari kryetar me mandat një-vjeçar u zgjedh Veli Deva me insistimin e Fadil Hoxhës, se situata ishte e rond. Veli Deva kishte qenë kryetar i Komitetit Krahinor ma herët deri në '71-shin.

Okej, mas Veli Devës m'doket ka qenë Sinan Hasani një vjet, Nisveta Dollasheviqi, serb. Qashtu e kqyrshmi atë rend, një vjet Kolë Shiroka, pastaj unë. Por u bo një ndryshim i statutit, jo një vjet po një vjet plus dy vjet, plus një vjet. Ashtu që unë isha '86-'87, '87-'88, në kohën e konfrontimit ma të madh me këta në Serbi. Masi mo mundësi statutore kish që unë zgjidhem, na në kryesi tham, “Ta rujm na unitetin e kryesisë”. Unë isha tepër i shënjestrum {përshkruan me duar} edhe ashtu prej Beogradit për shkak të parimeve në mbrojtjen e pozitës kushtetuese, sepse ju thashë që ishte ai debati rreth ndryshimeve kushtetuese.

Afrohej fundi i debatit publik dhe kalonte ajo temë mo. Serbët nëse nuk e realizonin qëllimin e vet ju ikte shanca. Kënd me zgjedh, situata e vështirë. I qitëm synin niherë Rrahman Dedaj një herë e kemi pasë anëtar i kryesisë. Ka qenë pak shëndetligë, por ka qenë i vendosun, i koqit. Ishte me atë ekipin tonë që ishim, që ishim shumë unik karshi presioneve të Serbisë për çështjet e ndryshimeve kushtetuese që ishin në rend të ditës dhe serbët qaty ishin përqendru krejt.

Ai nuk pranoi se ishte shëndetligë. Shkum me Kaqusha Jasharin e cila nuk kishte një përvojë politike, në '86-tën e kishim zgjedh si femër anëtare të Kryesisë të Komitetit Krahinor ndër ata 15 që ishin. Në atë situatë edhe ajo i pritonte. Tha, “Unë po e pranoj veç me një kusht”. Thashë, “Cilin kusht?” Tha, “Ti me metë në kryesi”. Thashë, “Po”, se unë isha edhe anëtar i Komitetit Qëndror të Jugosllavisë, na i kishim 15 anëtar të Komitetit Qëndror. Atje u thejshin shtizat, u vlerëru që osht' e nevojshme me qenë unë atje. “S'ka problem, unë jom aty. Qaty jemi na ekip, nuk o puna krejt te kryetari, individi”. Na e vlersojshim që Kaqusha nuk do të jetë e shënjestrum prej serbëve si unë që isha veç i shënjestrum. Na si ekip funksionojmë.

Por tani vazhdun presionet, vazhdun presionet. Përditë në rend të ditës në Kryesinë e Komitetit Qëndror të Jugosllavisë tema e Kosovës, presionet, serbët. U lodh edhe Kaqusha, aprovonin konkluzione edhe kundër udhëheqësisë të Kosovës kisha nuk osht' e aftë, nuk p'e stabilizon gjendjen. Na i thojshim, "Shiqo nuk o këtu puna e stabilizimit të gjendjes. Gjendja në Kosovë o stabile. S'pi nguc kërkush serbët, por osht' problemi jonë të instrumentalizum për presione m'i bo ndryshimet kushtetuese, me rikthy Kosovën në, nën jurisdiksionin kushtetues të Serbisë."

Masi e rrxunë siç thash udhëheqësinë e Vojvodinës, ishte kjo në tetor, tetor '88. Neve na u thy një krah i fortë, mbetëm na kosovarët në mbrojtje të pozitës kushtetuese kinse tu insistu në përgjegjësinë e Kryesisë të Komitetit Krahinor. Kaqusha u lodh, tha, "Unë pra masi po thuni që sun pe stabilizojmë gjendjen, qe unë po i jepi dorëheqje". Thamë, "Mo se marum". "Jom lodh". U lodhë.

Mu ma lujtën një punë tjerër. E bonën, e aprovunë një qëndrim tjetër kinse parimor në Komitet Qëndror të Jugosllavisë që një individ nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Komitetit Qëndror prej ndodnjë republike a krahine edhe njëkohësisht anëtar i Kryesisë të Partisë në njësi federale. Unë isha në të dyjat. Na e vlerësum, tash s'di a mirë a keq, por doli keq tani. E vlerësum, të tërhiqna unë pra prej pozitës të anëtarit të Kryesisë të Komitetit Krahinor, të mbetëm anëtar i Komitetit Qëndror të Jugosllavisë se në fund atje do të thehen shtizat për çështje të rëndësishme, ndërsa si anëtar të Komitetit Qëndror këtu në Kryesinë e Komitetit Krahinor gjithmonë do të jem prezent.

Por mas, në nëntor praktikisht ishte pregaditë krejt atmosfera, opinioni i përcillte ato presione ndaj nesh që po përmbysset udhëheqësia krahinore në qatë përmbamje që populli kishte kriju besim që na do ta mbrojmë pozitën kushtetuese të Kosovës. Me të drejtë kishte kriju populli ynë besim se na me të vërtetë aty e kishim vijën e kuqe dhe ishte një mbledhje e Komitetit Krahinor ku ndodheshin ato ndryshime.

Të parët që ka... dhe njëkohësisht mos të harrojmë, njëkohësisht {përshkruan me duar} shtoheshin presionet ndaj udhëheqësisë të Kosovës, shtoheshin për të kalue propozimet e Serbisë që Serbia të ketë kompetenca ma të mëdha mbi dy krahinat në atë kuptim që Serbia diçka që osht' në interes të saj në përgjithësi bashkë me krahina, ajo mund t'i imponon ato pa i vetë krahinat. Qaty ishte esenca. Opinioni i dinte ato.

Kur u pa që po rrezikohet qajo udhëheqësi që ishte një lloj garancioni për mbrojtjen e pozitës kushtetuese, u lëvizën ma s'pari minatorët e Trepçës. Minatorët pjesa, çdokund pjesa ma krenare e klasës punëtorë janë minatorët. Ata i bon puna ashtu krenarë, principiell dhe çohen qatë ditë që e kishim mledhjen e Komitetit Krahinor që u përhap se do të ndodhin ndryshime kadrovike, presionet jonë qeshtu, do të jetë krejt në dam të Kosovës.

Çohen minatorët e Trepçës në komë ja msynë Prishtinës në shejë... qe për çka: për t'i kundërshtu ndryshimet kadrovike me presione nga Beogradi {përshkruan me duar}, për të mos leju që të bohen ndryshimet jo veç kadrovike por edhe kushtetuese, se ishte debati për ndryshime kushtetuese, kundër ndryshimeve kushtetuese me presione nga Beogradi, qito ishin kryesore. Domethonë, ajo ishte lëvizja e parë e minatorëve në përkrahje të pozitës kushtetuese të Kosovës, pra të interesave tona kombëtare që i kishim realizu me qatë pozitë kushtetuese, kundër ndryshimeve kadrovike me presione, me përkrahje të kuadrave të neve që populli na konsideronte garancion për mbrojtje të qasaj pozite kushtetuese.

Na u gjetëm, u bo njifarë pauze me minatorët. Megjithatë, u kthymë në mledhje. Kaqusha e kallamiti diqysh, tha, “Hajde”, se na ishim unë, Ekrem Arifi, tham, “Kqyre çka? Po i shtyjmë këto ndryshime kushtetuese, s’bohet kjameti se kqyr kanë me ndodh lëvizje tash, trazohet opiniononi. Kjo është sheja e parë që populli po i kundërshton këto ndryshime se po shihet që jonë me presion. Kqyrim”. “Jo”, tha, “qeshtu qysh e kemi bo plan”.

Kalun ato dhe vazhdun pastaj protestat i nisën minatorët, m’duket që ka qenë me 17 nëntor ‘88-tën dhe katër-pesë ditë masanej në vazhdim në numër të madh kanë qenë lëvizjet e popullit prej të gjitha pjesëve të Kosovës. Do vinin në kamë në Prishtinë, do me vetura, do me autobusa. Vetëm simas vlerësimeve të policisë që i kanë përcjell ato lëvizje atëherë thonin 150 mijë deri 200 mijë njerëz qato pesë ditë kanë qenë në lëvizje. Ajo u shëndrru në një lëvizje të madhe paqësore, demokratike. Asnji incident rrugëve nëpër Prishtinë që vinin, defilonin, shkonin asnji incident nuk ka ndodhë, asnji parullë provokative kundër sistemit apo ofenduese ndaj tjerëve nacionaliste nuk ka pasë.

Nëpër Prishtinë, nëpër qendër të Prishtinës kanë defilu njerëz me flamur jugosllav, flamurin tonë shqiptar të lidhuna me portretin e Titos. A e dini pse? Ajo ka qenë si porosi e opinionit jugosllav që nuk o tu ndodh këtu kurrëfarë lëvizje armiqësore kundër Jugosllavisë dhe sistemit, por osht’ ftesë Jugosllavisë që të na mbron prej presioneve të Serbisë. Kjo osht’ lëvizje demokratike në kundërshtim të presioneve të Serbisë kundër kuadrave. Thojshin njerëzit, “Nëse nuk bojnë këta na nuk po bojmë be në këta kuadra, por nëse nuk bojnë na zgjedhim të ri, por jo Beogradi me na i ndrru”. Qaty ishte esenca. Masanej udhëheqësia...

**Anita Susuri:** A keni mbajt ju fjalim apo vetëm Kaqusha?

**Azem Vllasi:** Paj po, jo, jo kom majt edhe unë. Në stadion erdhën u mbush stadioni i futbollit me 20-30 mijë njerëz aty. Qëllimi ynë ishte t’i qetësojmë gjithë atë lëvizje, mos të ndodhë ndonjë eksese sepse u tutshim po futet gjendje e jashtëzakonshme. Po intervenon, qysh e çunë masanej në mars policinë prej tjetërkahit. Ushtria, po ndodh ma e keqja edhe na, “Mirë, faleminderit për përkrahje. Do t’i mbrojmë interesat e Kosovës. Nuk do t’i lejojmë...” U dukshin ato fjalimet tona para masës si pallavra që nuk ishim na në gjendje me thonë, “Mirë shumë edhe jemi kundër qatyne presioneve prej Beogradit”, që ishim. “Hajde tash të marrim në dorë çka kemi e të luftojmë me Beogradin”.

Kom majtë aty fjalime, në shumë vende. Dikur u lodha. Thashë, “Kqyre çka”, thashë në udhëheqësi aty, “S’po muj bre mo. Po m’doket vetja bajat. Këta çka po kërkojnë na s’jemi në pozitë, as unë. Çfarë premtimi me ju dhonë? A t’ju thojmë, ‘Kqyre s’ka ndryshime kadrovike’. Jo, jonë qëndrimet e Komitetit Qëndror, bohet tani llugë. Bohet edhe ma keq”. Këta pak të tjerët thojshin, “Apet tani çohen serbët në protesta e shkojnë në Beograd e bojnë atje”.

Ishte situatë shumë tollovi e madhe. Masanej, dy zhvillime ndodhën krejtësisht në drejtim shumë të keq, një drejtim në politikën kadrovike.

*[Këtu ndërprehet intervista]*

**Azem Vllasi:** Asaj thymje të madhe në nëntor ‘88-tën që populli u ngrit në mbrojtje të pozitës kushtetuese të Kosovës dhe të udhëheqësisë të vet. Dy zhvillime të këqija ndodhën. Njo në udhëheqësi, na për tu rikonsolidu disi e bonëm Remzi Kolgecin, që ishte anëtar i Kryesisë të Kosovës për ta ushtru detyrën që e la shprazët Kaqusha Jashari për një kohë deri sa ta gjojmë një kuadër të duhun. Mirëpo, pastaj përditë i vijnin prej Beogradi edhe prej Komitetit Qëndror të Serbisë edhe të Jugosllavitë aty.

E kishin pasë lodhë Serbinë, Remzinë edhe tani ai mu, Ekrem Arifin edhe pse ishim anëtar të Komitetit Kraninor, kishim shku prej Kryesisë. Ekremi shkoi tha, “Hajde kishe le t’i bjen që nime dikush po jep, po lëvizim diçka në kryesi”, edhe pse s’kish ai kurrëfarë përgjegjësie. Mua ju tregova që nuk bon dy funksione. I vinin aty, mu e Ekremin mo as që na thirrnin, Remzia s’guxojke prej ktyne të Beogradit. *Tët-tët-tët* {onomatope} i kishim aty do serbë, malazezë në udhëheqësi. S’di ka hinën zhvillimet krejt.

Kreun e shërbimit policor të Kosovës, kish dalë prej durëve tona sekretar, që i thojnë tash ministër, ishte Rrahman Morina. Ai veç kish ra në brazë të serbëve. Ishte njëfarë Isuf Karakuqi, Karakushi edhe aty njo dy serbë. Ata u fuqizunë, ishin kryesorë. Morina e Karakushi ishin faktikisht si marioneta për mjerisht në shërbim të tyne e jo, e jo marioneta pasive. E lujtën qysh e lujtën lojën e flliqt, Rrahman Morinën që njeri karrierën e punës të deri atëhershme e kishte pasë në polici, pa ditë qysh funksionon një organizatë themelore e partisë, e bonën kryetar të Komitetit Krahinor. Mo mu kush s’më thirre aty, as Ekrem Arifin, as na që ishim tham na murr dreqi.

Kahja e dytë që ishte, me insistimin e Beogradit prej shtabit të Millosheviqit, por edhe me përkrahjen e qitune kollaboracionistëve që e shitën shpirtin, Rrahman Morina, Jusuf Karakoshi e do serbë që ishin aty ja nisën me bo regjistrin e organizatorëve të protestave nëntorit ‘88-tën për të tregu që ajo ka qenë një lëvizje e *ujdurm* [trq.: e montuar] armiqësore kundër Jugosllavisë edhe kundër sistemit. Kinse diçka e ngjajshme si ‘81-shin, por kjo shumë ma masovike dhe kjo lëvizje kinse armiqësore e ka në krye një udhëheqës shumë ma serioz. E kush jonë ata? Azem Vllasi e do. Edhe me këmbëngulje që t’i japin lëvizjes të nëntorit një karakter krejt tjetër edhe kjo përcillet.

E kishin pasë bo listën. Thojnë, “92 njerëz i kemi, i ka policia të identifikume si organizatorë”. Dolën mes tyre krejt njerëz shqiptarë që kishin do emra prej jetës politike, ekonomike. Për shembull, nëse jonë nisë punëtorët e një fabrike të Gilanit e e kishin drejtor një me emër, thojshin, “Ai osht’ organizator se i ka leju, punëtorët s’kishin dalë”. Këta tjerët n’qatë mënyrë e kanë bo një regjistër, thojshin, “92 organizatorë”, kishe i kanë zbulu. Allah, çka jonë t’u bo!

Kur u panë krejt ato lëvizje domethonë, mas lëvizjes të nëntorit në ‘88-tën, nuk u ndal ai turr i presioneve të Beogradit, nuk ndodhi kurgjo mirë por u keqësu gjendja. Atëherë, minatorët u çunë apet në grevë, në fror ‘89-tën, por tash me një formë shumë ma të ashpër. Greva e urisë në zgafella, që grevë ma e vështirë s’ka. Jo në hapësirë, jo në ambient të hapur, jo si tash që po thojnë protestat, por grevë urie. Minatorët jonë dinjitoz, kokëfortë dhe u murr vesh që po ka ndodh greva në minierë.

Nuk shkoi shumë dhe u murr vesh kërkesat e tyre, kërkesat kush ju ka ndidhmu krejt n’rregull. Ato ishin kërkesa, tetë kërkesa. Krejt ishin me vend. Njo {përshkruan me duar} kërkohej dorëheqja e qitune udhëheqsave, qysh udhëheqsave, njerëzve shqiptarë që u reshtunë si kolaboracionist me regjimin e Millosheviqit, Rrahman Morina, Ali Shukrija...

**Anita Susuri:** Hysamedin Azemi.

**Azem Vllasi:** Hysamedin Azemi. Tani ishin, “I kundërshtojmë ndryshimin e pozitës kushtetuese të Kosovës me dhunë. I kundërshtojmë presionet tjera”. Krejt, mos t’i numroj me radhë. Të teta kërkesat ishin të arsyeshme që i meritonin t’i marrin forumet politike në shqyrtim. Me thonë, “Qikjo bon”. Me bo gjithë atë dramë për dorëheqje të tre idiotave që s’i dashke kërkush, apo disa sende tjera edhe mund të qetësohej situata. Por jo, e shtunë presionin prej Beogradi apet me me synim që jo kjo *ujdur* [trq.: montim] ma armiqësore, organizim armiqësor m’i kërku organizatorët.

Kush jonë organizatorë? Doli që udhëheqësit kryesorë të Trepçës, prej Aziz Abrashit, drejtor gjeneral, Burhan Kavajës, drejtor i minierës, do inxhinierë, udhëheqësa atje krejt me renome dhe disa minatorë që ishin aty gjatë grevës manin rend. Por, kush është megjithatë ai kryesori? E kryesori është Azem Vllasi. Pse Azem Vllasi? Millosheviqi ish’ mësu, ai fluturoi politikisht me mitingje, me përkrahjen e popullit serb kishe, ama shqiptarët nuk janë ata që guxojnë me përkrahë dikond, sepse shqiptarët sipas propagandës dhe qasjes të Serbisë, shqipëtarët mund t’i organizon ashtu dikund vetëm për një qëllim, vetëm me qëllime armiqësore ndaj sistemit (buzëqësh) e ashtu masovikisht mund t’i organizon dikush siç është Azem Vllasi.

**Pjesa e Katërt**

**Anita Susuri:** Deshta me lidh me grevën, ju po m'doket që i keni vizitu minatorët, por i keni vizatu, vizitu më falni, me një orë të vonë po m'duket?

**Azem Vllasi:** Tash të tregoj, shumë mirë. Unë deshta me të thonë masanej çka kom gjetë prej një stenogrami çka ka ndodhë në Beograd e m'u kthy këtu, por mirë më ktheve në kohë. Kur drama e grevës të minatorëve e përfshiu medialisht krejt Jugosllavinë, mediat botënore e murrën ato si ngjarje shumë unike specifike. Minatorët s'kanë kërkesa as për rroga as për kushte të punës, por kërkesa politike në interes kombëtar. Asi, dhe në Beograd në mledhje t'u debatu, hajde merrën vesh me ardh Stipe Shuvari<sup>7</sup> që ishte atëherë kryetar me mandat një-vjeçar i radhës, kryetar i Kryesisë të Komitetit Qëndror të Jugosllavisë, por me Millosheviqin si kryetar i Komitetit Qëndror të Serbisë në Kosovë me udhëheqësat e Kosovës, udhëheqësat (buzëqesh) merre me mend Rrahman Morinën u marrë vesh qysh me dnërpre grevën.

Kur vijmë në Prishtinë, Millosheviqi qysh u konë mashtrues, me Rrahman Morinën shetisin dikund nëpër Prishtinë, shkojnë në udhëheqësinë e KEK-ut që i thojnë tash qaty. Shuvari vet, m'doket me Remzi Kolgecin shkojnë te minatorët. Vizitojnë, por Shuvari pa kurrëfarë mandati as guximi që me thonë, "Po, cilat jonë kërkesat? Qe unë po ju premtoj që këto kërkesa pranohen. I diskutojmë në Kryesi të Komitetit Qëndror të Jugosllavisë", ja, ja. Se me pasë thonë ai ashtu Millosheviqi në Beograd menjëherë ia kish organizu mitingun para ndërtesën e Komitetit Qëndror. Kështu ka funksionu Millosheviqi.

Shuvari kurgjo hiç s'mundet me ju premtu. Minatorët thojnë, "Jo, nuk ke vyjt, nuk ke vyjt me u mundue. Natën e mirë!" Kur kryhet ajo kanë shku gazetarët atje. Ka qenë edhe gruaja jeme që ishte gazetare e "Vjesnikut" e Zagrebit, raportonte. U kthy, vallahi ishte kah ora nontë në mramje. U kthy e tronditun, e përlotur. "Çka u bo? Çka ndodhi sot? A përcjelle?" "Mos vet!" Tha, "Ke Shuvari. Neve nuk na lëshun atje krejt, por vizita e tij asnji rezultat edhe ata kanë vendosë mos me dalë prej greve pa u plotësu kërkesat e tyne. Dikush po thotë jonë në gjendje të vështirë, kanë me vdek".

Ajo m'preki mu si njeri. S'po muj, a beson... {pauzon}. Tash qata njerëz janë që më kanë përkrah mu në nëntor [1988]. Qata njerëz jonë, e di çfare jonë, kush jonë. Kurrë një kërkesë, diçka të papranueshme asmiqësore as kundër. Thashë, "Vetëm të shkoj t'i shoh". Nuk kisha unë autorizime me thonë, "Çka po kërkoni a mundet?" Jo, t'i shoh si njerëz. Qëlloi me mu [Bahria], e që ja pa sherrin se ato tani e murrën në burg (buzëqesh). Bahri Oruqi kojshia jem, që me një kohë kishte qenë Drejtor Gjeneral i Trepçës, kishte qenë kryetar i Qeverisë të Kosovës.

Thashë, "Bahri, du me shku". "Edhe unë du me shku me ty". E shkumë bashkë. Kur shkumë atje te porta në Stantërg, ai atje në portë tha, "Mirëmrama", na njofti. Thashë, "Na e dijmë, krejt jemi të

---

<sup>7</sup> Stipe Šušar (1936-2004) ishte një politikan dhe sociolog kroat i cili konsiderohej të ishte një nga politikanët komunistë më me ndikim në Lidhjen e Komunistëve të Kroacisë në Republikën Socialiste të Kroacisë gjatë Jugosllavisë dhe më vonë në Kroacinë moderne.

informumë. Asi, jemi shumë të bomë merak. Veç pak”. Tha, “Kanë thonë kërkond mos me pranue mo, përveç nëse ju vjen naj lajm që jonë pranue kërkesat e tyne”. Valla thashë, “Na me asi lajmi jo, por si njerëz jemi shumë...” Tha, “Po e veti”, e veti dikon. Kur ka vetë kanë thonë, “A Azem Vllasin bon, lshojeni”. Shkova, zbritëm poshtë me lift me Bahrinë.

E pamë një atmosferë të tmerrshme, kurrë s’e harroj në jetën teme. Nuk u dike a osht’ ai ambienti {përshkruan me duar} shkëmbinjët e minatorëve, e minierës apo fytyrat e njerëzve. Kish ishin mbështet këtu asi, s’di as çka me ju thonë. Tha, “Kqyre, krejt opinionioni kosovar e ma gjonë osht’ tu e përcjellë dramën e juve. Krejt, por krejt jemi të bomë merak shumë. Tepër jemi të shqetësues për gjendjen e juve shëndetësore”. Tha, “Faleminderit që keni ardhë”. “Çka boni ju për me ndërpre këtë mënyrë të grevës. S’po ju thom me hjekë dorë prej kërkesave të juve, por për shëndetin e juve dilni në sipërfaqe edhe vazhdoni. As s’jom unë që deklarohna, as s’më ka çu kush”. “Faleminderit, faleminderit për vizitë!” Dulëm unë edhe Bahria me ndjenja ma, ndjenja ma të ronda se që kur shkumë.

U ktheva, nejta edhe pak. I pashë do ata stacionarë të shtrimë që kishin dalë pak me marrë veten. U kthymë.

**Anita Susuri:** Në cilën ditë të grevës ju keni shku?

**Azem Vllasi:** Hë?

**Anita Susuri:** Cila ditë e grevës u konë, a e dini përafërshit?

**Azem Vllasi:** U konë, mund të jetë e gjashta, po. Tani të nesrit, qashtu i shqetësues, unë e dijsa që krejt t’u përcjellë, krejt. Unë nuk kom shku në vizitë sekrete as të fshehtë. Pse? As s’kom shku me ju premtu diçka siç thashë, por s’mujsha me nejt i qetë, mos me shku në vend me pa çka po ndodhë me ta. Të nesrit masi më kanë përcjellë krejt, thërret Rrahman Morina i gjori. Jo, ma s’pari me telefon në banesë më thërret Slllobodan Millosheviqi. Prej përpara, s’ish problem atëherë telefonat, i kishim celularë. Tha, “Kqyre kjo në Trepçe e pe sheh çka o t’u ndodhë?” Thashë, “Po, p’e shoh. P’e shoh edhe”, thashë, “je konë dje. Ki mujt me gjetë naj zgjidhje, ti e Shuvari s’keni bo kurgjo. Situata osht’ shumë dramatike”. Tha, “Po duhet me ndërpre”. Tash, “Po ju keni vyjt dje me bo diçka”. Tha, “Ti ki autoritet. Ti duhesh me ndërmarrë diçka me ndërpre këre grevë”.

Thashë, “Tash edhe unë...” Thash, “A din çka? Unë me pasë autoritet s’ishin mundu në të gjitha mënyrat me më ndjek prej Komitetit Qëndror. I keni gjetë kuadrat tjera”, thash, “për në krye të partisë të Kosovës. Thash, “Po supozoj që i keni gjetë me autoritet se vetëm njerëzit që kanë autoritet sikur kur je ti aty e këta pa autoritet heken”. Ja nisi pakëz me ironizu, i kishim ato raportet e vjetra thuja armiqësore, por në përgjithësi komunikojshim qështu me fjalë me njoni-tjetrin.

Tha, “Kqyr”, tha, “asi nuk o mirë. Bohet edhe ma keq”, anej-knej. Thashë, “kqyrni ju, unë”, thash, “muj me shku vetëm nesë dikush më autorizon më thu me thonë: Kërkesat e juve jonë pranë. Asi autorizimi”, thashë, “e di që s’më jep kush” edhe e ndërpreme bisedën. Më lenë pak kohë. Ma vonë më thirrë Rrahman Morina. “Çka po bon?” “Qe, qitu”. “Ani, a po vjen me pi një kafe?” “Ani”, thashë, “pije. Sigurisht t’paska tregu Millosheviqi që m’ka thirrë”. Hala pa shku s’muj po durohna. Kur shkova, ai i gjori në zyrën e vet. Tha, “Kqyre, ti ishe konë atje”. “E di që e edini ju, krejt jeni t’u përcjellë. Nuk jom konë”, thashë, “në vizitë sekrete”, thashë, “po, jom konë edhe çka kom pa mos vet”.

“Kqyr”, tha, “duhet me bo diçka me i hjekë, m’i nxerrë, me ndërpre”. Thashë, “taman duheni me bo diçka. Unë”, thashë, “qeshtu m’tha edhe Millosheviqi, por ju mundeni ju që keni pushtet, keni funksione”. Thashë, “Unë s’jom kërkushi. Çka me bo unë?” Tha, “Po dikush i ka organizu”. Thashë, “Jonë organizu ata”. Vet ai qysh u konë i shkretë tha, “Po thojnë”, tha, “që edhe ti kie dorë në organizim”. Thashë, “Po këto thojnë qysh prej protestave të nëntorit edhe ju keni thonë sa je konë ti në polici e keni bo listën”, thashë, “të organizatorëve”. Thashë, “S’po t’vjen marre e tani ti po lypë këtu dorë armiqësore”. Thashë, “Kqyre çka po të thom. P’i lypin dorëheqjen tonde, por mu me m’u çu njëqind vetë, me konë unë qaty me lypë dorëheqjen teme, dy ditë s’kisha pritë”.

Tha, “Jo”, tha, (qesh) “nuk p’i di arsyet pse po kërkoni dorëheqje”. Thashë, “S’pi din a?” Po, thashë, “Kqyre ti njeri”, se na majshim raporte. Thashë, “Ti n’paqe thirrë me bo hajgare me mu, mos bo hajgare. Po ti”, thashë, “qashtu ku je e gjithë kjo dramë me ndodhë e di që kjo dramë ish’ ndërpre me ju plotësu qitë kërkesë. Çka po të vyn ai vend?” Tha, “Kanë kërkesa tjera”. “Për krejt kërkesat tjera mundet me u diskutu. Do mujnë edhe mos me u përkrahë, por m’u diskutu s’ka problem”. Asi thashë, “Mos bo hajgare”.

Thashë, “Unë kisha shku”, thashë, “apet. Po m’dhemb ajo çka po ndodhë me ta. Kisha shku veç me një kusht, me ardh ti edhe Remzi Kolgeci bashkë edhe aty bashkë na te tretë me shkrim me marrë edhe me ja u lexu që kërkesat e tyne pranohen, qito për dorëheqje, qito për asi {përshkruan me duar}. Jonë domethonë qito-qito, do të diskutohen me seriozitet. Qashtu”, thashë, “po. Ndryshe po”, thashë, “në shpi jom, i gatshëm jom, kqyr me Remzinë. Ndaq qeshtu shkojmë te tretë, por me qitë kusht”. “Ani, ani”, tha, “shko”, asi. Çfarë të thirrmi, e dijsa që s’më thirrë edhe atëherë ai me Millosheviqin veç jonë bo planet me shku në akcion të burgosjeve.

Të nesërmen atë natë po e përcjelli unë çka po ndodh në Beograd. Ja ka nisë Millosheviqi, apet ai me atë, me mitingje në mesnatë... se mos po kaloj çka ndodhi. Në mesnatë rektorin e Universitetit të Beogradit m’i lëvizë studentët prej qendrës të studentëve në Beograd që osht’ larg njo katër-pesë kilometra prej qendrës të Beogradit. Gjithë ditën, e gjithë ditën mbledhi njerëz qysh mbledhshin nëpër mitingje në Beograd. I sjellin gjithë ditën, me sa m’kujtohet ishte 28 shkurti a... Edhe atje ata gjithë ditën t’u kërkuan intervenim ndaj Kosovës, luftë kundër nacionalistëve shqiptarë, anej-knej.



Ai del në mramje para asaj mase në Beograd. Aty në ato mitingje jonë konë ajo bërthama e porositun. Çfarë parullash me bo? Çka me kërkue? Edhe ajo bërthama në miting të Beogradit, sot e kësaj dite sillet në ato skena. Bërtasin, “*Uhapsite Vlasija, uhapsite...!*” “Burgoseni Vllasin”. Ai bohet kishe s’po ju nij {vendos dorën te veshi} çka po folni, që s’po ju nij. Thotë, “Kush i ka përdorë njerëzit atje do të burgosen dhe do të dënohen. E këto për unë, atë ditë kur e pash çka po ndodh, tubimi në Beograd. Nadirja [bashkëshortja] ishte si gazetare tu i përcjell ngjarjet. Unë i marr me kerr se e dijsa mu diçka çkado që të ndodhë nuk do të m’anashkalojnë.

I marr në Prishtinë në kerr kah ora katër a pesë masdite Ademin e Sellmen t’i çoj te familja e Nadirës në Bielinë në Bosne që osht’, 140 kilometra larg prej Beogradit. Thashë ata le t’jenë të sigurtë atje edhe t’kursym prej këtij tmerri çka do të ndodhë. S’pe di, të ndodhë çka të ndodh. Kur kom... edhe po përcjell në radio gjithë ditën mitingun në Beograd. Çfarë rastësie si për film, pikërisht t’u kalu une nepër Beograd për me vazhdu rrugën përtej për Bosnje dhe në Bielinë te familja e Nadirës, ato e nij tu folë në miting edhe tu premtu që burgosje, anej-knej.

I dërgova fëmijët atje. Të nesërmit deshta m’u kthy në Prishtinë. Ndodh çka të ndodh duhet m’u ballafaqu me situatën, s’ki ka ikë prej vetës edhe prej vendit tonë. As s’kisha arsye me ikë dika, s’kisha bo kurrëfarë vepre penale. Nesrit njihna me Nadirën në telefon, tha, “Pritëm”, tha, “edhe ti nesër se osht’ ni kolege e jemja Jelena Llovriq prej Zagrebit këtu, po kthehet me kerr e i bijnë ka Bielina. Unë rri, tani unë e ti kthehem bashkë”. “Ani”, thashë, “po rri edhe një ditë”. Ai në mramje vonë e kanë aktivizu mekanizmin për burgosje. M’kanë përcjellë mu, krejt e kanë ditë ka po shkoj. Dhe ai mekanizëm ka qenë ashtu që kërkesa nuk jom në Prishtinë, jepet kërkesa policisë të Bosnës që të m’gjonë në Bosne, të m’sjell të Prishtinë.

Në mramje vonë vijnë trokisin te dera e familjes të Nadirës policia e Bosnës. “Kërkojmë falje”. “Çka ka?” “Kanë thonë me ju sjell në Prishtinë”. Thashë, “Po unë me kerr temin jom edhe ashtu t’u shku nesër në Prishtinë”. “Jo, na kanë thonë me neve duhesh me shku”. “Hajde hajr i koftë”. Nadirja veç ish’ nisë e smujsha me i lajmru. Unë me kerr te policisë të Bosnës në drejtim të Prishtinës, Nadirja prej Prishtinës në drejtim {përshkruan me duar} të Bosnjes me makinën e asaj kolegës të vet Jelena Llovriq. Tani masanej vonë diskutojshim, thojshim, “Dikun jemi tejkalu po s’pe dijmë, s’pe dijmë ku”.

Dhe më sjellën në polici. Thashë, “Çka o more kjo? A bon me bisedu me këta. Kush? Çfarë urdhëni kanë dhonë?” “Jo, jo, qe. Jo, jo, qe”, m’ikshin kur... “Ku osht’”, thashë, “qaj Jusuf Karakuqka ta shoh?” “Jo, jo asi”. Në mramje erdhën deri e kishin përgaditë me më çu për Mitrovicë. Para, ato procedurat me caktu paraburgimin, me na... qeshtu më kthyn prej Bieline. Përfundova në zyret e policisë në Prishtinë. M’çunë në Mitrovicë... Çka po bojmë tash? A me vazhdu qitë tregim a?

**Anita Susuri:** Unë deshta... m’duket me Burhan Kavajën jeni konë me një qeli, a po m’duket?

**Azem Vllasi:** Tash ju tregoj. Në gjyq po hijmë atje. P'e shoh çka po ndodhë. Pse në Mitrovicë? Në Mitrovicë kinse vendi i krimit (qesh) greva. M'shtijnë, vonë ishte kah ora dhjetë në mramje. Një gjyqtar, tani e morra vesh, quhej Avdi Dinaj. Ja kishin dhonë detyrë, ai njeri s'kishe... i habitun, njerstë i shkojshin kështu {përshkruan me duar}. Qatje ish' ulë njo, p'e shoh pak si i gzushëm. Tani e morra vesh ishte prokurori Spasoje Zamfiroviq.

“Kërkesa” tha, “osht' kërkesa e policisë, prokurorisë për shkak të dyshimit të bazuar se keni kry vepër penale *tët-tët-tët-tët* {onomatope} kundër rendit kushtetues, neni 134 lidhur me nenin 139 prandaj deri sa të vazhdojnë hetimet, të caktohet masa e paraburgimit për një muj ditë”. Thashë, “Allahile, unë nime une jurist i diplomum jom, por kom punu në politikë e s'pi di. Çka osht' qaj neni 139?” Unë e dijsa. “Po, kështu”, tha, “osht' e tani masanej...” “Jo, jo”, thashë, “po e lexova, vlla. Unë... po”.

Neni 134, organizimi armiqësor kundër sistemit. Lidhur me nenin 139, kinse në atë organizim kanë ra edhe viktima, e tani e morrëm vesh që si viktima i llogaritshin dy policë në ato trazirat apert në rezistencë të popullit që kanë ndodhë masi Serbia i festojke ndryshimet kushtetuese. Na ishim njëzetë ditë veç në burg, dy policë veç ishin vra, njo në Podujevë, njo te Deçani. Na i ngarkojshin neve, domethonë me pasoja të vdekun e që ishte me nenin 139 i parapamë dënimi me vdekje, ka qenë atëherë dënimi me vdekje.

Pe kqyri unë (bezëqesh). Ai i shkreti ma lexoi, i shkojshin njerstë qeshtu {përshkruan me duar}, lyp e sjellë krytë, “Allah, Allah, Allah”. E përfundum. Ky prokurori keshke edhe p'i thotë atina, “Zna” [srb.: E dinë] tha, “E dinë”, tha, “ky, por t'shtini me lexu”. Shkum në qeli. Masanej unë aty në izolim hermetik, vetëm kanë pasë obligim me njoftu Nadirën që unë jom atje, s'ka problem. Kadal kadal unë prej atyne gardianëve marr vesh që u burgos Aziz Abrashi, Burhan Kavaja, tani do udhëheqësa tjerë të minierës, Ibush Jonuzi, Riza Musliu, Mensur Fejza, do. Burhanin e Azizin i njifsha mirë, këta të tjerët s'i njifsha.

Na shtinën në ato procedura. Na në qelia izolimi total qaty brenda qatij burgut rrotull {përshkruan me duar} në Mitrovicë, që o i tmerrshëm. Por asnjo s'e kanë lonë dy veta në një qeli, kinse mos m'u konsultu diqysh qysh me u mbrojtë e asi. Edhe qaty i kemi kalu 14 muaj. Mas gjashtë muajve e kemi marrë aktakuzën të burgosjes. Mas tetë mujve prej kur ka fillu gjykimi, qatëherë jemi pa në sallën e gjykimit. Krejt, “Aha, a jeni? Si jeni?” A po kupton? Gjashtë muaj ka zgjatë gjykimi edhe ky kolegji gjykues edhe kryetari i kolegjit, Ismet Emra ka qenë i ndjeri. Krejt e dijsin që ajo është një aktakuzë politike, s'ka t'boj asgja me vepër penale.

Me 24 prill vendimi i gjyqit, aktakuza nuk është vërtetue, hudhet dhe shpallen të lirë. Na dulëm të lirë. Ishte situatë e tmerrshme, represioni gjithkah, njerëzit e frikësuar. Qatë ditë krejt opinionin kosovar e ka përcjellë. Ka qenë një ditë gëzimi që u lirum na. Ishin mbledhë populli në Mitrovicë, nuk na lanë me kalu nëpër qytet kordonin e policisë, na kthynë ka Zveqani me dalë në rrugë, secili ka shpijat e veta. Mu m'kish ardhë me kerr më marrë shoku im prej shkollës së mesme dhe avokati im Hasan Hoti.

Erdha në Prishtinë. Në Prishtinë ishin mbledhë njerëzit. Hypa në banesë prej terase pak me i përshëndet njerëzit, kur e pashë kordonin e policëve mas njerëzve që ishin mbledhë. As nuk isha që po ju maj naj fjalim, se thashë mos p'i rrehin. "Faleminderit, Faleminderit. Ditën e mirë!" Qe qeshtu përfundoi kjo, ma s'shkurti.

**Korab Krasniqi:** A ka qenë edhe deri sa keni qenë në burg është organizu edhe një grevë e cila nuk ka pasë bujë sa kjo e shkurtit. A t'kujtohet? A e dini çka...?

**Azem Vllasi:** Tash kështu, se i rash për së shkurti. Mas grevës ka ndodhë greva e minatorëve. Lidhur me grevën e minatorëve në Stantërg, minatorët e të gjitha minierave, në Novobërd e Golesh po ashtu kanë hy në grevë. Punëtorja, një lëvizje e madhe e popullit apat atëherë ka ndodhë krejt të motivum me grevën e minatorëve të Trepçës dhe qysh u ndërpre ajo grevë pastaj? I kanë rrejtë, ja u kanë çu lajmin e rrejshëm se po aprovohen kërkesat dhe minatorët kanë dalë. Mesa unë e di, sipas tregimit të Burhanit e kanë mshelë mos me mujt me u kthy atje.

Kanë dalë rrena këtu dhe kanë fillu burgosjet. Pastaj kanë tentu apat për shkak të burgosjeve që i rrejtën, apat me ndodhë një grevë, m'u fut atje, por i kanë blloku, s'i kanë lëshu. Ma vonë, dikur me fillim e gjykimit tona a s'di në cilën fazë apat ka pasë një tentim greve, i kanë hi do policë specialca. Thojshin u konë një Radovan Stoiqiq-Baxha i kanë thonë, i Njësisë Speciale të Serbisë. Intervenim atje me ja u tregu muskujt. Qatë Radovan Baxha që i thojshin në ato qërim hesapesh e grupeve mafioze në Beograd, e vranë serbët midis Beogradi.

Kanë ndodhë protesta që na prej mrena në qeli nuk marrshim vesh, diçka çka m'përshpëritshin avokatët kur ardhshin apo gardianët. Kur në Serbi Kuvendi i Serbisë i ka aprovu ato ndryshimet kushtetuese me të cilat ajo i jep vetit të drejtë që kurdo që vlerëson që jonë në interes munden me pru ligje që shtrihen edhe në territorin e krahinave, në Beograd u festu, këtu ka pasë protesta masovike të shqiptarëve. Jonë vra me sa e kom marrë vesh 19 a njëzet njerëz, neve na i ngarkojshin në aktakuzë kishe na kena faj, jemi fajtorë për vrasjen e atyne policëve e na kishin fut në aktakuzë atë nenin që thashë 139. Domethonë, ajo vala e protestave ka vazhdu në mënyra të ndryshme me intenzitet të ndryshëm, sepse prej shkeljes të autonomisë tani ndodhi në situatë krejt tjetër.

Harrova t'ju thom, masi atij mitingu të Millosheviqit në Beograd kur ka premtue burgosje, që kërkujshin burgosjen tem e asi. Millosheviqi, sipas tregimeve të pastajshme, që m'ka tregu Stipe Shuvari në Zagreb, Millosheviqi ka shku në ndërtesën e Kryesisë të Jugosllavisë ku kanë qenë ata aty prezent me kqyr çka po ndodh, drama e minatorëve në Mitrovicë, gjithë ditën miting në Beograd dhe Millosheviqi ju thotë, "Përkrahjen e kryetarit të Kryesisë të Jugosllavisë", që ka qenë Nikolla Lubiçiqi, thotë, "Duhet me shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë për me bo rend se përndryshe atje osht' situata llugë. Në Kosovë osht' rebelim kundër shtetit. Shqiptarët dojnë me rrënu Jugosllavinë. Duhet me bo një rend".

Dikush në kryesi atje, “Por kadale, a osht’ situata ashtu? Pse? Çka po...?” Thotë, “Nëse nuk vendosni gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë atëherë qaj miting që ishte sot në Beograd e unë e qetësova”, Millosheviqi thotë, “nesër keni me pasë para zyreve të juja qatë miting”. A zyret e kryesisë ishin atje, mozomakeq tash i thojnë “*Palata Serbia*” [srb.: Pallati i Serbisë], ishte Pallata e Federatës, ajo ndërtesa imponante në Beograd të Ri. E vendosi gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë. Gjendja e jashtëzakonshme, gjendja e shtetërrethimit osht’, përdoret tani policia, forca. Çunë forca policore, federale, të republikave, krahinave ka pak, por aty mas tyne kryesorët Serbia për ta vendosë gjendjen e jashtëzakonshme.

Ajo ishte në të vërtetë gjendje e përdorimit, si të quhet e dhunës në përmasa të gjëra, e dhunës joselektive. Nuk i ndali ajo krejt protestat e shqiptarëve, por ama ajo, ai përdorim i dhunës i përmasave të tilla i frikësoi popullin. Njerëzit kanë pasë, kanë duru tortura. Mua ju duk pak që më çunë mu në burg, m’i kanë marrë dy djem të vllaut të madh në ato izolimet famëkeqe që ishin. I murrën me regjistër kur u përfshi në izolim policor. Ata s’ishin në kurrëfarë procedure. Neve që na shtinën në procedurë hetimore-gjyqësore barem kishim të drejta avokat e procedurat, ata hiç.

Njonin prej të vllavit tem e futën edhe në procedurë gjyqësore. E gjykun, por doli i lirë se s’kish bo kurgjo. Tjetrin e kanë dërmu gjatë izolimit e ashtu sa e sa njerëz kanë qenë në qato izolime e në qato, por dhunë drejt me ju thonë, dhuna për momentin bon kërdi por nuk e ka jetën e gjatë. E te na valla dhuna serbe e gjatë a e shkurte, dhjetë vjet zgjati.

## **Pjesa e Pestë**

**Anita Susuri:** Këto vitet e ‘90-ta kanë qenë kur jonë mbyllë institucionet për shqiptarët, jonë largu prej punës. Qysh kanë qenë për juve qato vite?

**Azem Vllasi:** Unë kur dola prej burgut në prill të ‘90-tës isha në dilemë çka t’boj. Unë isha i shënjestrum prej serbëve si armiku numër njo i Serbisë. Rrethanat kishin ndryshu krejt. Sistemi insitucional i kohës mo nuk ishte. Lidhja e Komunistëve aty shqiptarët, shqiptarët kanë qenë në Kosovë, anëtarët t’parët në Evropën Lindore që masovikisht e kanë braktisë Lidhjen e Komunistëve. Lidhja e Komunistëve e Kosovës i ka pasë nja 100 deri 105 mijë anëtarë, besbeli që shumica kanë qenë shqiptarë sipas popullsisë.

Mas protestave të nëntorit, kjo o me randësi m’u ditë, e i kanë kthy kur i kanë pa që vlerësimet partiake prej naltit jonë apsolutisht të gabushme sepse në vend se me pa pse ndodhën ato protesta këtu që jonë në mbrojtje të pozitës kushtetuese, kqyrshin me ja u dhonë kahjen armiqësore. Tani kur u zgjedh Rrahman Morina kryetar i Komitetit Krahinor i kthynë librezat masovikisht dhe mo, nuk kishte mo as Lidhje të Komunistëve të Kosovës as kurgjo. Krejt ai sistem ra.

Formalisht, prej ramjes të murit të Berlinit, prej nëntorit, dhjetorit '89-tën, '89-tën, pluralizmi partiak që thojshin u legalizu. Mo me organizu naj grup partiak, parti politike nuk ishte vepër penale dhe qatëherë u formu LDK-ja [Lidhja Demokratike e Kosovës]. Mandej, "LDK boni çka t'doni ama pushteti çizme serbe". Në ato rrethana tek shqiptarët nisi masi që krejt shqiptarët faktikisht ishin të konfrontum me atë rezhim të dhunës të Serbisë të instalum këtu. Me organizu një jetë t'i themi paralele institucionale, funksionojshin këshillat për ndihma.

LDK-ja u u formu, u bo masi kish metë zbrazëti politike. Ajo doli jo si një organizatë politike, por si një lëvizje politike. Krejt shqiptarët për të qenë dikund të kësaj masovikisht u bonë anëtarë të LDK-së. U dashke jetën, do segmente të jetës me i organizu. Arsimi, arsimi o punë e ndijshme. Serbia i mbylli shkollat, i mbylli arsimin sepse kërkoni që tashti shkollat shqipe krejt funksionojnë sipas programeve të sistemit të Serbisë. Na kishim mrri në atë nivel me pa një arsim në gjuhën tonë për neve, për nevoja të Kosovës dhe kuptohet që në një gjo të tillë shqiptarët nuk pranoni.

U organizu sistemi paralel arsimor nëpër lokale private, nëpër... lami të ndryshme, domethonë ishte një, mund ta quaj gati një lëvizje e organizimit paralel të shqiptarëve për mbijetese në kushte të okupacionit. Unë isha i afërt qaty dikund. Formalisht m'u kyç najkun, me marrë një librezë partiake jo. Unë si emër që isha nga koha çka ndodhi, çka m'ndodhi kisha kontakt të shumta me diplomatët e huaj, me gazetarët e huaj, me media dhe kontributin tem e jipja në qatë mënyrë.

Kur doli se Jugosllavia po zhbëhet, në Unionin Evropian apo atëherë i thojshin Bashkësia Evropiane u formu një komision i ekspertëve të drejtës ndërkombëtare në krye me atë Bandinterin i thojnë sot, Komisioni i Badinterit me pa cilat janë kushtet për formimin e shteteve të reja masi që Jugosllavia po zhbëhet, dhe aty të gjitha njësitë federale ishin drejtë kërkesës, sllovenët, kroatët, ata veç deklarativisht e shpallën pavarësinë në qershor, '91-shin. Për Bosnje kërkohet që ta majnë referendumin, Maqedonia poashtu. Komisioni i Badinterit e mori t'i shqyrtoj kriteret nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare.

Na masi kishmi qenë njësi federale me Kushtetutën e '74-tës, aty në ato zyrtat e LDK-së që ishte Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, unë shkoja shpesh se këta gazetarët e huaj, diplomatët kur ardhshin, krejt takimet me Rugovën, me shqiptarët çka kishin qaty, s'kishim mundësi tjetërku. Shkojsha shpejtë, me Rugovën unë njihesha prej kohës së studimeve. Një ditë e takoj, Rugova tha, "Ti e din qysh ka funksionu Kosova me Kushtetutën e '74-tës e krejt, e din çka ka ndodhë. A ulesh me na bo një propozim edhe na ta çojmë te Komisioni i Badinterit që edhe Kosova t'e lyp të drejtën për shtetësi". Thashë, "Pa problem e boj".

U ula. Për dy-tri ditë e bona atë propozim. E dërgova te Rugova, por ishte problemi që Komisioni i Badinterit e kishte marrë detyrën që t'i jep vlerësimet prej gjendjes të gjetun të '91-shit. Gjendja e gjetun në '91-shin ishin gjashtë republika, a dy krahinat që ishin element konsitutiv i Federatës sipas Kushtetutës së '74-tës, por '89-tën Serbia po thom i kish gëlltit dhe Komisioni i Badinterit për atë

arsyeje nuk e morri në konsiderim që edhe dy krahina kanë qenë element konsitutiv i Federatës a në Vojvodina as që lypke kush. Atje ishin, megjithatë shumica serbe. Aty ishte një diferencë e madhe mes Kosovës edhe Vojvodinës dhe ajo ishte arsyeja pse Kosova tani mbeti ashtu.

Krejt të huft që ardhshin, “Hajde qysh me bo një zgjidhje politike. Mos të kërset lufta”. Krisi lufta në Bosnje, këta të huft veç thojshin, “Boni diçka mos t’bohët tragjedia e Bosnjes”. Rugova edhe qato e kishte. Rugova ka qenë njeri paqësor, por edhe përvojën e Bosnjes e kishte. Bota s’po din çka me bo me Bosnjen, te na okupacion, okupacion, por të mos bohët tragjedi edhe ma e madhe. Ajo gjendje u duru dhe mos t’harrojmë edhe një punë.

Kur erdh tani në fund të fundit, mas intervenimit të NATO-s, administrata e UNMIK-ut mbi Kosovën për disa vite edhe u bo shumë mirë se na rivitalizunë. Zgjidhet statusi, e mori Martti Ahtisaari atë detyrë në emër të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkume. Përveç të drejtave tjera, përmes drejtës ndërkombtare që jonë marrë parasysh, na bazë të cilës sipas planit të Ahtisaarit, Kosova ka mujt ta shpall shtetësinë osht’ marrë edhe ajo që Kosova në gjendjen legale, legjitime të Jugosllavisë ka qenë element konsitutiv i Jugosllavisë sipas Kushtetutës të ‘74-tës.

*[Këtu ndërprehet intervista]*

**Anita Susuri:** Si e keni kalu ju luftën? Ku keni qenë?

**Azem Vllasi:** Kuku.

**Anita Susuri:** Çka keni bo?

**Azem Vllasi:** Kjo nime te koka për tre ditë. Situata vinte dukshëm tu u ashpërsu. Në vitin 1988, ‘87 po, ‘88 pasi që lëvizja paqësore dhe demokratike që e simbolizonte dhe e udhëhiqte Ibrahim Rugova për zgjidhjen e statusit të Kosovës, faktikisht për pavarësinë e Kosovës nuk dha rezultate. Atëherë doli krahu i armatosur i lëvizjes për çlirimin e Kosovës.

*[Këtu ndërprehet intervista]*

**Azem Vllasi:** Në vitin 1989 veç fillunë luftimet mes grupeve të UÇK-së. Doli Ushtria Çlirimtare e Kosovës si formacion i organizum, i armatosun për çlirimin e Kosovës. Bota akoma bonte do përpjekje që të gjindet një zgjidhje paqësore. Zgjidhje paqësore nuk kishte. Shtabi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që ishte në Drenicë kishte emëru Adem Demaçin për përfaqësues politik të zyres politike të UÇK-së me seli në Prishtinë. Adem Demaçi e kish pa të arsyeshme t’i thërret për bashkëpunëtorë do njerëz për të vepru në planin politik, mediatik dhe diplomatik.

Një ditë më thirri mu, shkova. E kishte marrë një zyre atje, na i thojshim, “Te devizat” (buzëqesh) te Pazari i vjetër, ku ka qenë Gjykata e Qarkut. Shkova te Ademi. Tha, “Kqyre mu ma kanë dhonë qitë detyre do bashkëpunëtorë, ti ki kontakte me diplomatët e huaj, me gazetarë, asi me spjegu çka o t’u nodhë këtu, çlirimet e UÇK-së”. Thash s’ka problem, secili prej nesh o i obligum sa mundet me dhonë kontribut” dhe për disa muaj bashkëpunum mirë me Ademin.

Ndodhi takimi në Rambuje si përpjekja e fundit e ndërkombëtarëve për ta evitu konfliktin e armatosur në Kosovë dhe për t’i dhonë shancë një zgjidhje politike. Serbia as ato nuk e pranoi dhe perëndimi vendosi të intervenoj, mos me leju të ndodhë tragjedia në Kosovë si ajo në Bosnje. Unë me Nadirën vendosëm me metë në Kosovë sepse kur dola unë prej burgut fëmijët, Ademin dhe Sellmën veç ishin në shkollë të mesme, është dy vjet diferenca mes tyne. E gjeta një program të mirë shkollor amerikan për një vjet dhe i dërgumë në Amerikë me qatë program e të kqyrim çka po ndodhë.

Po ata atje u gjetën mirë, e vazhdunë shkollimin, na metëm këtu. Masi s’kishim gajlen e fëmijëve të vegjël qysh kishin njerëzit tjerë. Veç te thom këto, Ademi e Sellma tash jonë atje. Ademi u bo avokat, osht’. Sellma mjeke. I kanë familjet e veta, shpijat e veta. Unë e Nadirja shkojmë, vijnë ata najherë. Metëm na këtu, Nadirja si gazetare. Unë këtu ishta me qitë bashkëpunim me Adem Demaçin n’qitë zyren politike.

Në Rambuje, dështoi Rambujeja. E dijsim bombardimet po ndodhin, por sikur që kanë mendu në NATO edhe Serbia ka mendu edhe na kemi mendu disa ditë do të zgjatë ajo fushatë, dhe megjithatë do të gjindet një zgjidhje. Kërkush s’e ka llogaritë që do të zgjatin bombardimet 78 ditë. Unë e Nadirja metëm në Prishtinë. Mas dy dite u ndërpre në lidhjet telefonike, u bo tmerr. Kur mora vesh që kolegun tem Bajram Kelmendin natën e fillimit të bombardimeve me dy djem e kanë marrë, e kanë pushkatu qatje në drejtim të Fushë Kosovës, unë e Nadirja i hypëm makinës.

Për fat, në drejtim të Gjilanit knej ishte akoma lëvizja deri dikund pak ma e sigurtë. Mrrinëm këtu ku jemi sot, në një vikendicë tonën, shtëpizë e kemi pasë. Por situata ishte e tillë, na nuk rrinëm këtu por në shtëpinë e babës tem, babës Ahmet. Aty kushërinjët, na kemi qenë të organizumë, madje edhe të armatosur. Nëse vijnë na sulmojnë në shpi, në shpi për t’u mbrojtë. A për të dalur rrugëve, maleve jo. Kjo ka qenë... Mas shtatë ditëve bandat serbe kush erdhën ma kallën vikendicën natën, natën e kallën.

Kojshitë këtu s’kanë qenë, s’kanë lëvizë poshtë e naltë e kësajde. Ditën pak takoheshim, lëvizshim. Krejt e kanë përjetue keq kalljen e shpisë teme si shejë që ja kanë msy edhe fshatit tonë, qityne tri-katër mahallave sa jemi.

**Anita Susuri:** A veç shpinë e juj e kanë djegë?

**Azem Vllasi:** Veç shpinë teme. Nuk ka pasë këtu as të vramë as asi... bile kojshitë, “A bre u bo dom”. Hajt thojsha, “Ju marrtë të kqijat krejt t’juvet shpija jemi. Për fat këtu {përshkruan me duar} mahalla e

Jakupëve e Llozanëve, na Vllasët, Gajtonët nalt s'ka pasë as të vramë as dame të tjera. Një dom material ka qenë djegia e shtëpisë teme. Masanej e kom bo qe apet jom qitu. Përveç qitu s'e kom rrxu krejt me temel. Ka metë një shesh e themelit të atëherëshëm (qesh).

**Anita Susuri:** Edhe krejt luftën e keni kalu pastaj këtu në fshat me familjen e ju?

**Azem Vllasi:** Me ta, po. Metëm këtu. Flenim te baba jem atje. I kishim do masa mbrojtëse. I përcillnim na lajmet e jashtme, lëvizja, njerëzit po ikin në drejtim të Shqipërisë, por po ndjekën në drejtim të Maqedonisë. E këtu e kishim Maqedoninë mas afërmi, mirëpo mu s'ma merrke menja me ja mësy rrugëve me turma. E kisha problemin që serbët policë e krejt mu më njihnin. Tash nëse, që thojnë, "U shkru me vdek". Ma mirë në shpi teme se me më gjetë dikund rrugëve, me më sha, me më vra. Ashtu që, deri ditën e fundit me Nadirën kemi qenë qitu te baba jem, nana m'ka vdek në '93-tën.

Atë ditë kur kapituloi Serbia, u aprovu Rezuluta 1244, Marrëveshja e Kumanovës për dinamikën e tërheqjeve të forcave serbe. E përcjellsim na dinamikën. Na nuk u turrëm menjëherë në Prishtinë, unë e Nadirja. Tham se në ato ndryshimet, na ato tollovitë, ndhodhin tmerret thojnë. Ma s'keqti o kur vdesin njerëzit, vriten masi nalet lufta se gjatë luftës. Kur marrëm vesh që jonë tërhjekë, na i hypëm kerrit tash si ngadhnjimarë dhe u tmerrum prej Prishtine dy ditë mas fillun bombardimet edhe masi njeva çka i ka ndodhë kolegut tem Bajram Kelmendit e u kthymë.

Kah u kthejshim prej këtij drejtimit, me sa e di në drejtim të Prishtinës shkonin korsat franceze për të vazhdu në Mitrovicë edhe na me ta. Kur erdhëm në Prishtinë, atje ishin vendosë këta të KFOR-it anglez. Kur mrrinëm te banesa jonë, një kojshi tash i ndjeri, Karahman Celina kishte mbet në dritare. Na pa, tha, "Kthehuni te une {përshkruan me duar}, mos shkoni në banesë të juven". Hajde hajr i koftë. "Kojshi a keni? A jeni gjallë?" "Gjallë jemi, qe asi..." "Ani", tha, "mos hi se", tha, "banesën e juve e kanë thy, kanë hi kanë plaqkitë edhe mos ka naj send, naj shpërthim apo asi". Nuk shkumë.

Shkova qatje, tash i thojshin Restarurant "Rugova", qatje do këta të punktut anglez ishin vendosë në punkte të ndyshme. I luta, thashë, "A bon me ardhë qeshtu qeshtu mos ka". Kqyrim", thanë, "Ku jeni?" "Nuk jom larg". Erdhën me ato *tët-tët-tët* {onomatope}. Banesën e kishin shkatërru, kishin televizora, kompjutera krejt. Por masi ushtarët anglez më thanë shpërthim diçka nuk ka e prunëm, ishim për herë të parë unë e Nadirja, po thom kaniherë si studentë, pa pare, banesa e shkatërrume, shpia a kallun. E fillum jetën e re.

**Anita Susuri:** Qysh vazhdoi pastaj jeta për juve edhe nëse doni për fund diçka me shtu?

**Azem Vllasi:** A e bojmë boll? Jeta mas (qesh), mas '99-tën, mas qershorit '99-tën? Jeta jeme vazhdoi, unë vazhdova punën teme si avokat që e kisha fillu masi dola prej burgut, dy vjet masanej. Njo dy vjet pas burgut fitoja paratë për t'bo një jetë normale si kollumnist, bashkëpunëtor njëherë i "Slobodna Dalmacisë" në Split. Pagujshin diçka mirë, ka njo 700-800 marka atëherë. E botova librin "Përjetimet



nga burgu”, atëherë rasti jem ishte aktual në Jugosllavi. U shit libri mirë, e botova në Kroaci, në Zagreb dhe dulën pak do pare.

Në bazë të qatij librit osht’ xhiru një film në Sarajevë, njëfar Faruk Sokolloviq producent, e ka xhiru një film. Mirëpo u përshpejtunë zhvillimet tragjike. Në ‘91-shin lufta në Kroaci, pastaj në Bosnje, e mas ‘99-tës unë vazhdova si avokat, por në kushte krejt të tjera. Nja shtatë-tetë vjet me gjykatësit tanë po, por edhe këta të UNMIK-ut që kanë qenë edhe të EULEX-it deri para dy-tri vjete, atë dinamikën e punës të avokatisë e kom pasë të mirë.

Në kohë të fundit i kom lonë këto punët e përditshme të avokatisë. Naj landë e madhe, naj firmë prej jashtit me ra do probleme që zgjidhen me marrëveshje, jo në procedurë gjyqësore. Me Nadirën këtu jemi kryesisht. E kemi një bazë në Dalmaci shkojmë najherë, fëmijët në Amerikë dhe kështu kalon jeta jonë në këtë moshën. Si quhet? Mosha e tretë.

**Anita Susuri:** Po, faleminderit shumë zotri Azem për kohën edhe për durimin.

**Azem Vllasi:** *Ouu!* {onomatope} (qesh)